

1 E enjte, 24 gusht 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes dhe mirë se vini pas seancës së fundit që mbajtëm
8 të hënën.

9 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
12 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, znj. Sekretare e Seancës.

15 Ju lutem, z. Prokuror, na prezantoni kush është i
16 pranishëm për Prokurorinë sot.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
18 Gjykatëse. Për ZPS-në të pranishëm sot në sallën e gjyqit janë
19 Line Pedersen, Zuzanne Gorczynska, Gaia Pergolo, Federica
20 Genovesi dhe Filippo de Minicis.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Mbrojtës i Viktimave.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Jam unë i pranishëm, Simon Laws, për
24 këtë çështje.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Avokati Mbrojtja.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
4 Gjykatëse. Kemi znj. Leto Cariolou, që është bashkëavokate dhe
5 z. Aouini, i cili do të jetë me ne sot. Kemi gjithashtu edhe
6 menaxheren e çështjes znj. Petravica. Edhe kemi edhe dy
7 stazhiere të tjera.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Shala, a konfirmoni që më dëgjoni? Më dëgjoni z. Shala?

10 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj shumë
11 mirë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Mendoj që kishte një problem me kanalin, se ishin në kanalin e
14 anglishtes. Besoj që u zgjidh.

15 Pra, sot kemi Konferencën për Përgatitjen e Mbrojtjes që
16 paraprin hapjen e çështjes së Mbrojtjes, siç parashikohet në
17 rregullin 119 të Rregullores.

18 Rikujtoj, që të hënën, më 21 gusht 2023, Trupi Gjykses
19 përcaktoi rendin e ditës për konferencën e sotme. dhe u
20 urdhëruan palët dhe Mbrojtjen e Viktimave që të dorëzonte
21 parashtrim me shkrim sa i takon pikave në agjendë deri të
22 mërkurën, datë 23 gusht 2023. Më datë 22 dhe 23 gusht 2023, ne
23 morëm parashtrime me shkrim nga Mbrojtësi i Viktimave,
24 parashtrimin e protokolluar 616 dhe nga ZPS-ja, parashtrimin e
25 protokolluar 617 dhe Mbrojtja parashtrimin e protokolluar 618.

1 Qëllimi i konferencës sot është që të përgatisim
2 paraqitjen e provave nga Mbrojtja. Ne do të kalojmë rendin e
3 ditës së përcaktuar nga Trupi Gjykses. Do të trajtojmë disa
4 prej pikave që janë ngritur nga parashtrimet me shkrim të
5 Mbrojtjes së ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave. Më pas ju do
6 t'ju jepet mundësia që të ngrini çështje të tjera të cilat i
7 konsideroni të rëndësishme për të diskutuar në këtë konferencë
8 për përgatitjen e Mbrojtjes. Edhe nesër do të japim disa
9 urdhra dhe udhëzime pasdite duke filluar nga ora 2. 30.

10 Përpara sesa të fillojmë me pikën e parë të rendit të
11 ditës, kujtoj që nuk është e rëndësishme që të përsërisni ato
12 që keni thënë në parashtrimet me shkrim. Pasi kemi mbajtur
13 shënim, mbajmë parasysh ato çfarë keni parashtruar me shkrim.
14 Nëse mendoni se është e rëndësishme që të kaloni në seancë
15 private, ju lutem na njoftoni për këtë gjë.

16 Pika e parë në rendin e ditës ka të bëjë me hetimet e
17 Mbrojtjes.

18 Avokat, e kuptojmë që ju duhet ende ca kohë për të
19 përfunduar disa takime me dëshmitarë potencialë. Për të qenë
20 të qartë, dua t'ju pyes në qoftë se dëshmitarët potencialë për
21 të cilët ju flisni janë personat të cilët nuk janë në listën e
22 dëshmitarëve deri tani; dhe, në qoftë se, përgjigja është po,
23 Trupi Gjykses dëshiron që të dijë për sa vetë bëhet fjalë, për
24 sa dëshmitarë të tjerë potencialë bëhet fjalë.

25 Po ashtu mbajmë parasysh edhe atë çfarë keni parashtruar

1 ju që këto takime të mëtejshme me dëshmitarët e mundshëm nuk
2 do të çojnë në vonimin e paraqitjes së provave prej jush.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
4 Ne mendojmë që pika kryesore është që hapat përfundimtarë të
5 hetimeve nuk do të çojnë në vonesa ose pengim të procesit të
6 paraqitjes të provave.

7 Sa i takon numrit të individëve me të cilët ne do të
8 takohemi, fatkeqësisht janë disa persona me të cilët ne
9 dëshironim që të takoheshim përpara kësaj pjese, por nuk e
10 kemi pasur të mundur. Po flasim për katër persona të ndryshëm
11 që gjenden në katër shtete të ndryshme. Ndërkohë tre prej tyre
12 janë pjesë e listave tona të dëshmitarëve. Për njërin prej
13 tyre na duhet që të bëjmë një takim.

14 Në qoftë se dëshironi mund t'ju japim numrat, të nderuar
15 Gjykatës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
17 ju lutem.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Do shikoj listën dhe do jap
19 pseudonimet më mirë sesa emrat.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Jemi në seancë publike kështu që
23 duhet të jemi të kujdesshëm.

24 Dëshmitari i parë është 4405. Është dëshmitar të cilin
25 nuk kemi pasur mundësi që ta takojmë deri tani.

1 Do kemi, domethënë, gjithashtu edhe 4754 është dikush që
2 nuk e kemi takuar deri tani se fatkeqësisht ka pasur një
3 operacion kohët e fundit. Dëshironim që të sillnim këtu në
4 Holandë edhe dy persona të tjerë në mënyrë të tillë që të mund
5 të bisedonim me to, po për arsye shëndetësore të këtyre
6 personave është e pamundur që ata të sillen këtu, kështu që si
7 rezultat do të duhet që të udhëtojmë në mënyrë që të takohemi
8 me ta. Bëjmë fjalë përkatësisht për dëshmitarin 4754.

9 Po ashtu nuk arritëm në misionin tonë të fundit që
10 takoheshim me Dëshmitarin DW4 -- një çast e nderuar Gjykatëse.

11 Është DW4-05, për rrethana personale të personit.

12 Më i rëndësishmi, të nderuar Gjykatës, është Dëshmitari
13 DW4-04, me të cilin jemi takuar rreth vjeshtës së një viti më
14 përpara në Kosovë. Por që prej kësaj kohe, ky person është
15 zhvendosur në një vend tjetër për arsye mjekësore dhe duket
16 sikur ka probleme të mëdhaja shëndetësore. Kështu që të paktën
17 na duhet që të takohemi me të për të vlerësuar se në çfarë
18 pike janë kushtet shëndetësore. Sepse ne nuk kemi një
19 deklaratë nga ky individ. Kështu që siç janë gjërat deri tani,
20 ne po mendojmë se në qoftë se ky person është në gjendje që të
21 jap dëshmitar ndoshta mënyra më e mirë për të marrë dëshminë e
22 këtij dëshmitari është përmes videolidhjes, sepse është e
23 vështirë për këtë individ për të lëvizur dhe për të ardhur
24 këtu.

25 Përderisa ne kemi ca informacion lidhur me shqetësimet

1 shëndetësore që ka personi, do të duhet që të vlerësojmë në
2 qoftë se nga vjet deri në sivjet nuk është cenuar
3 përshtatshmëria e tij për të dhënë dëshmi përpara Trupit
4 Gjykues. Për këtë arsye do të dua që të zhvillojmë këtë takim
5 përpara sesa t'ju informojmë të nderuar Gjykatës sesi do të
6 vazhdojmë lidhur me këtë dëshmitar.

7 Sikurse e përmendëm, të nderuar Gjykatës, e kemi thënë
8 edhe në parashtrimet tona, kemi kontaktuar me disa ekspertë
9 për t'u marrë me disa prej dëshmive të viktimave të
10 paraqitura, do të kemi mundësi që t'ju japim një përgjigje apo
11 të japim një informacion shtesë pasi kemi organizuar një takim
12 dhe pasi të kemi marrë disa këshilla nga ekspertët.

13 Për Mbrojtjen plani është që ekspertët do japim dëshmi në
14 fund fare, pra, në bllokun e fundit të grupit të dëshmitarëve
15 dhe në atë pikë, në qoftë se do të kemi më tepër informacion
16 apo në qoftë se do të kemi dëshmi të dëshmitarëve ekspertë,
17 dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë do të bëhen në fund të të
18 gjithë dëshmive të Mbrojtjes. Në qoftë se do e kemi, me siguri
19 që do kemi një dëshmitar të tillë, atëherë do bëjmë ndryshime
20 në listë e dëshmitarëve në kohën e duhur.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa i
22 takon dëshmitarit ekspert, do të jepni raportin më herët apo
23 jo?

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Sapo që të përcaktojmë individin,
25 ta kemi të sigurtë se kush është individi, do ju japim të

1 gjitha dokumentet e nevojshme.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur
3 flisni për ekspertë e keni fjalën për një ekspert apo për disa
4 ekspertë?

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Në këtë pikë, të nderuar Gjykatës,
6 bëhet fjalë më tepër për pjesën ekonomike të prezantimit të
7 viktimave dhe po mundohemi, po përpiqemi që të vlerësojmë të
8 kemi një ose dy dëshmitarë ekspertë të cilët të vërtetojnë
9 standardet ndërkombëtare. Deri në këtë pikë nuk kemi gjetur
10 ende një person që ka cilësimet, kualifikimet e duhura në
11 Kosovë për të shpjeguar aspektet ekonomike të cilat janë të
12 përshtatshme për Kosovën. Sapo të kemi një informacion qoftë
13 ai pozitiv apo negativ sigurisht që do t'ju informojmë se deri
14 në çfarë faze jemi. Në qoftë se do të kemi emra të
15 dëshmitarëve ekspertë, sigurisht, të nderuar Gjykatës, do
16 t'jua bëjë me dije këtë informacion dhe do bëjmë ndryshimet e
17 listave të dëshmitarëve tanë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit, Avokat.

20 Në qoftë se i kam numëruar mirë, pra, kemi katër
21 dëshmitarë, që ju i përmendët si 4405, 4704, 05 dhe 04, që do
22 të përpiqeni që të kontaktoni me ta. Dhe të katër këta persona
23 janë pjesë e listës së dëshmitarëve tuaj. Kështu?

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Ndërkohë që ekspertët, dëshmitarët ekspertë potencialë nuk
2 janë pjesë e listës tuaj, apo jo?

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Do të ketë një çështje konkrete me
4 4405, të cilën mbase do të duhet që ta trajtojmë, ta
5 shtjellojmë më vonë sepse nuk kemi pasur mundësi që të
6 vendosim ndonjë kontakt me këtë individ. Megjithatë jemi
7 shpresëplotë dhe shpresojmë do të kontaktojmë me të, kështu që
8 do të bëjmë dh enjë orvatje të fundit për të kontaktuar me
9 këtë individë apo për t'u takuar me të. Mbase kjo do të
10 relizohet më vonë në pajtim me rregullën 153, 154.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Znj. Prokurore, dëshironi të ngrini ndonjë gjë lidhur me
14 këtë.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.
16 Falënderojmë Avokatin për sqarimin që na dha sa i takon
17 dëshmitarëve. Sigurisht, një ndër pikat që do të duhet që të
18 sqarohet është që sa dëshmitarë duhet që të takojë Mbrojtja,
19 shpjegimin për të cilën na e i dha kolegu. Megjithatë është e
20 nevojshme për neve që të kemi sqarime të mëtejshme sa i takon
21 DW4-05, sepse nuk e kemi të qartë në qoftë se ka pasur ndonjë
22 takim më herët me këtë dëshmitar apo takimi që pretendon
23 Mbrojtja që të bëjë është takimi i parë dhe, po ashtu, është e
24 rëndësishme për ne që të dimë sesi ka pasur mundësi Mbrojtja
25 që të japë informacione nëpër mbledhje në qoftë se nuk është

1 takuar me këtë dëshmitar më herët.

2 Këto dy gjëra do të donim që të sqaroheshin.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, znj. Prokurore.

5 Z. Avokat, e keni ju fjalën.

6 Z. AOUNI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

7 Dëshmitari DW4-05 është dikush që ne e kemi takuar më
8 herët dhe duhet të bëj dallim ndërmjet DW4-05 me W04405 se
9 numrat janë pak të ngjashëm që është në fillim, domethënë, ka
10 qenë ky personi i fundit ka qenë dëshmitar i Prokurorisë. Pra,
11 edhe njëherë në përgjigje të Prokurores, DW4-05 është dikush
12 të cilin ne e kemi takuar. Pra, është një dëshmitar të cilin e
13 kemi takuar. Jepet në numrin 11 në shtojcën e parashtrimit
14 tonë dhe ky është një individ i cili pritet që të japë dëshmi
15 në sallën e gjyqit. DW4-02 ka konfirmuar disponueshmërinë e
16 tij për bllokun e dytë ose grupin e dytë të dëshmitarëve që do
17 vijjnë të dëshmojnë këtu në sallën e gjyqit, e ka konfirmuar
18 këtë gjë, pra, për të dhënë dëshmi, nga data 2 deri më 6
19 tetor, në qoftë se nuk e kam gabim.

20 Ky do të jetë një takim i brendshëm që do të kemi me të
21 për të konfirmuar disponueshmërinë e tij, për të diskutuar për
22 disa hollësi të tjera. Megjithatë, siç e thashë, është një
23 person me të cilin kemi diskutuar më përpara dhe është i
24 planifikuar për të dhënë dëshmi në bllokun e dytë të
25 dëshmitarëve të Mbrojtjes.

1 Shpresoj që isha i qartë për Prokuroren.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
3 Prokurore, u sqaruar.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po. Faleminderit, e nderuar
5 Gjykatëse.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Mbrojtësi i Viktimave, dëshironi të thoni diçka.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Jo. Faleminderit, e nderuar
9 Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Atëherë nuk është e nevojshme të vazhdojmë me një raund të
12 dytë. Dhe mund të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të
13 ditës. Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me nxjerrjen e
14 materialeve që synon Mbrojtja që të paraqesë përpara Trupit
15 Gjykes se duke përfshirë këtu edhe inspektimin e objekteve të
16 prekshme.

17 Avokat, na keni informuar ne përmes postës elektronike,
18 mesazheve elektronike, të premtën, më datë 18 gusht 2023, si
19 dhe në parashtrimet e shkruara të marra dje, që ju e keni
20 përfunduar nxjerrjen e të gjitha materialeve që synoni që të
21 paraqisni në gjykim përfshirë këtu edhe objektet e prekshme. A
22 ka diçka tjetër që dëshironi që të shtoni lidhur me këtë pikë?

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Të gjitha
24 gjërat që kishim për të sqaruar i kemi sqaruar më herët.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Prokurorja, ka ndonjë për të shtuar?

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo. Vetëm sa për të konfirmuar
3 që i kemi marrë nxjerrjet e të gjitha materialeve nga lista e
4 provave materiale të Mbrojtjes.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Ndonjë për të thënë, z. Laws?

7 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Tani do të kalojmë në një temë që u përmend edhe nga
11 Prokurorja, bëhet fjalë për deklaratat e mëhershme dhe
12 shënimet e bisedave me dëshmitarët.

13 Avokat, na keni informuar që nuk kemi marrë deklarata nga
14 dëshmitarët 02, 03, 04, 05 dhe 06. Po ashtu keni thënë gjatë
15 takimeve që keni organizuar me ta nuk kemi mbajtur shënime. E
16 shoh që tundni kokën.

17 Ajo çfarë kam lexuar është që ju thoni se nuk keni marrë
18 shënime sepse dëshmitarët kanë frikë që të jenë të përfshirë
19 dhe të dalin haptazi, e kemi mbajtur shënime këtë gjë.

20 Megjithatë, Trupi Gjykes dëshiron që të dijë pak më tepër. A
21 mund ta shtjelloni pak më tepër ju lutem se për çfarë kanë
22 frikë dëshmitarët, sepse, nëse e kam kuptuar drejt, frika nuk
23 është në një masë të tillë sa që ju kërkoni masa mbrojtëse për
24 këta dëshmitarë.

25 Dhe pyetja e dytë për të cilën do të doja më tepër

1 shpjegime është që ju na keni dhënë përmbledhje të
2 dëshmitarëve, për disa prej tyre ju nuk kemi deklarata të
3 mëparshme, por keni dhënë vetëm thjesht përmbledhjen e tyre.
4 Kështu që do të doja të na e shpjegonit sesi keni pasur
5 mundësi që të merrnin informacionin që ata do të japin
6 deklarata ose informacion për tema të caktuara. Nuk është
7 pyetje sarkastike, nuk është sarkazëm. Por thjesht dua që të
8 marr vesh më tepër se çfarë keni për të thënë lidhur me këtë
9 çështje.

10 Kjo ka të bëjë në veçanti me dy dëshmitarë dhe lidhur me
11 ta ne duam që të kemi informacion më konkret lidhur me atë
12 çfarë ata do të thonë përpara Trupit Gjykses ose të paktën
13 çfarë prisni ju që ata të dëshmojnë përpara Trupit Gjykses në
14 mënyrë të tillë që të jemi në një pozitë më të mirë që të
15 vlerësojmë sesa relevante janë dëshmitë e tyre.

16 Fjala është për ju.

17 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, patjetër. E prisnim këtë
18 pyetje, e nderuar Gjykatëse.

19 "Frikë" mbase është fjalë shumë e përgjithshme.
20 Megjithatë ajo çfarë kemi parë, çfarë kemi përjetuar ne, në
21 fakt, përpara sesa të fillonim këtë proces gjyqësor kemi pasur
22 një konferencë *ex parte* me ju, të nderuar Gjykatës, ku ju kemi
23 shpjeguar ngurrimin e personave për të fol me ne. Ka pasur
24 raste ku e kemi provuar katër-pesë herë, një individ i
25 caktuar, për shembull, pranon që të takohet me ne po pastaj

1 nuk i përgjigjet pyetjes.

2 Besoj se është e sigurtë të thuhet që ato kanë një lloj
3 ngurrimi sa i takon institucionit, procesit. Disa prej tyre
4 duhej që të sqaronin aspektin e bashkëpunimit me ne,
5 domethënë, aspektin vullnetar të bashkëpunimit me ne.

6 Dhe mënyra më e mirë për të siguruar që këta persona
7 vinin për t'u takuar me neve ishte duke mos mbajtur shënime,
8 domethënë dhe duke bërë takime të një natyre më informale. Sa
9 më informal të ishim ne në takimet me këta persona aq më e
10 mundur ishte për neve për të pasur bashkëpunimin e tyre dhe
11 për ruajtjen e këtij bashkëpunimi.

12 Nuk është se do t'i cek të gjitha problemet që kemi
13 pasur. Por, shumë individë fillimisht pranuan që të takoheshin
14 me neve, pastaj refuzuan që të takoheshin me ne dhe kur shkon,
15 kur udhëton në një vend tjetër është goxha nervozuese që ti
16 shkon atje dhe mund të takosh me personat me të cilët ke rënë
17 dakord që të takohesh paraprakisht.

18 Sa herë që ne kemi organizuar takime joformale, duke i
19 pyetur ata për gjëra që dinë dhe gjëra që nuk dinë, e kemi të
20 konstatuar se kur nuk kemi mbajtur shënime, kjo na ka bërë që
21 të kishim mundësi që të takoheshim edhe herë të tjera me këta
22 individë dhe që ata të mund të na ndihmonin me dëshmitë, me
23 provat dhe me përvojën e tyre.

24 Kjo është arsyeja që pse nuk kemi mbajtur shënime. Por
25 pas takimit me këta individë ne kemi bërë një përmbledhje të

1 bisedës me ta, duke reflektuar pikat e rëndësishme për ne, të
2 cilat shpeshherë janë pika konkrete, të cilat demonstrohen në
3 përmbledhje. Të nderuar Gjykatës, në qoftë se keni pyetje për
4 elementë të tjerë në qoftë se doni që të themi diçka sa i
5 takon relevancës së dëshmisë së dëshmitarëve, të individëve të
6 tillë, nga përvoja jonë, ne sigurisht, që jemi të gatshëm që
7 të japim mendimin tonë. Ne kemi marrë pjesë të paktën dy apo
8 tri herë të tjera në takime të tilla dhe, sigurisht, që jemi
9 të hapur t'ju japim të gjithë përvojën tonë dhe gjithçka çka
10 dimë lidhur me këto takime dhe me këtë çështje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit, i nderuar Avokat.

13 Znj. Prokurore, fjala për ju.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
15 Gjykatës. Falënderojmë kolegët e Mbrojtjes për këto shpjegime
16 edhe ne na duhej ca informacion për të kuptuar procesin dhe
17 për të kuptuar sesi është mbërritur në informacionin e dhënë
18 në përmbledhje.

19 Megjithatë, kur lexojmë përmbledhjen, na krijohet
20 përshtypja sikur duhet të ketë informacion shtesë që mund të
21 ketë Mbrojtja, që ka çuar në vendimin për të shtuar dëshmitarë
22 të caktuar në listën e tyre. Sikurse e tha Mbrojtja, këto
23 janë, domethënë, ndoshta nuk kanë mbajtur shënime gjatë
24 takimeve por më pas, pra, pas takimeve kanë bërë një
25 përmbledhje të asaj çfarë është diskutuar në takime të tilla.

1 Për shembull, në lidhje me DW4-06, Mbrojtja thotë që do
2 ta thërrasë këtë dëshmitar që të dëshmojë se ku ndodhej atë
3 natë dhe të shpjegojë sepse nuk ka qenë në fabrikën e
4 përpunimit të metalit në kohën e pretenduar nga Dëshmitari
5 4733.

6 Qëndrimi ynë është që Mbrojtja duhet të dijë lidhur me
7 vendin ku gjendej ky dëshmitar dhe arsyen pse nuk ka qenë në
8 fabrikën e përpunimit të metalit.

9 Në mënyrë të ngjashme, nuk ka informacion sa i takon
10 kohës se kur W4-04 nuk ka qenë -- ishte në Kukës. Dhe, sërish,
11 edhe në këtë rast, Mbrojtja duhet që të ketë më shumë
12 informacion. Se në të kundërtën i takon se nuk është as
13 Mbrojtja e qartë me rrethanat dhe me gjërat e tjera lidhur me
14 këtë dëshmitar.

15 Sigurisht, që ne jemi të vetëdijshëm që rregulla 106
16 përcakton se produkti i brendshëm i punës dhe shënimet e
17 brendshme të punës për Mbrojtjen apo për palët e tjera nuk
18 duhet që të ndahen, megjithatë, ne mendojmë që duhet që të
19 marrim informacion që ka të bëjë me përmbajtjen e provave që
20 do të japë dëshmitari, sigurisht, me nxjerrjen e informacionit
21 dhe në përputhje me rregullat e tjera.

22 Ne mendojmë që nxjerrja e këtij informacioni do t'i bëjë
23 të mundur Trupit Gjykses që të vlerësojë, së pari, relevancën
24 e këtyre dëshmitarëve dhe, së dyti, në një fazë më të vonë,
25 besueshmërinë e tyre dhe mbështetshmërinë e tyre duke i

1 konfrontuar ato në qoftë se do jetë e mundur me deklaratat të
2 mëhershme apo me dokumente të tjera të cilat janë marrë nga
3 Mbrojtja.

4 Pra, ne besojmë që kjo në vetvete është e domosdoshme,
5 është thelbësore për të bërë të mundur përgatitjen efikase të
6 çështjes së Mbrojtjes dhe për të bërë gjykimin më të
7 efektshëm.

8 Këto parashtime kemi ne për momentin. Faleminderit, e
9 nderuar Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, znj. Prokurore.

12 Atëherë dua që të bëjmë ca sqarime. Pra, dëgjova dy
13 kërkesa konkrete që kanë të bëjnë me sqarime të mëtejshme
14 lidhur me Dëshmitar 6 dhe Dëshmitarin 4.

15 A kërkon ju, domethënë, a kërkon ZPS-ja që qartësimet të
16 jepen për këta dy dëshmitarë apo kërkon sqarime më të gjëra?
17 Sepse në qoftë se kërkon sqarime më të gjëra pastaj do
18 formuloj sesi e kam kuptuar pyetjen tuaj. Ju thoni se lidhur
19 me dëshmitarët për të cilët nuk kanë deklaratat që janë, pra,
20 që Mbrojtja ka përpiluar vetëm përmbledhjet, ju thoni që doni
21 të keni materialin provues shtesë që ka Mbrojtja dhe që nuk ka
22 të bëjë me shënimet e brendshme.

23 Dhe e shoh që ju po tundni kokën në pohim, domethënë,
24 gjithsesi do ju jap fjalën në mënyrë që ta formuloni
25 përgjigjen e pyetjes që sapo bëra.

1 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kjo është e saktë, e nderuar
2 Gjykatëse. Ne i kërkuam Mbrojtjes që të nxirrte informacion
3 tjetër shtesë në çfarëdolloj forme që e ka marrë këtë
4 informacion dhe që ka vlerë provuese. Mendojmë që ky
5 informacion do të na ndihmojë ne dhe palëve për të përgatitur
6 për provat e Mbrojtjes.

7 Po ashtu kemi parashtrime të tjera më të hollësishme
8 lidhur me mjaftueshmërinë e përmbledhjeve që na është dhënë
9 nga Mbrojtja sa i takon disa dëshmitarëve si dhe relevancën e
10 disa prej këtyre dëshmitarëve. Kolegët do të komentojnë në më
11 tepër hollësi lidhur me këto pika por mendojmë që vendi i
12 përshtatshëm për të ngritur këto shqetësime është në pikën 11
13 të rendit të ditës. Ne i kemi parashtrimet lidhur me këtë
14 pikë.

15 Por, duke ju kthyer edhe një herë çështjes së nxjerrjes
16 së materialeve, ne do t'i kërkonim Mbrojtjes që të nxjerrë
17 informacione të tjera shtesë që kanë marrë nga dëshmitarët.
18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit, znj. Prokurore.

21 Mbrojtësi i Viktimave?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj të
23 mbështes atë çfarë sapo u tha nga Prokurorja. U formulua shumë
24 mirë. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Avokat, fjala për ju. Dëshiroj që të dëgjojmë
3 këndvështrimin tuaj si Mbrojtje lidhur me kërkesën e bërë nga
4 ZPS-ja.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
6 Dua ta them edhe një herë tjetër, informacionin që kemi është
7 përmbledhur dhe është nxjerrë për ZPS-në. Mbase kjo nuk është
8 e qartë për ta sa i takon relevancës, megjithatë unë mund të
9 jap disa shpjegime lidhur me dy individët që sapo u përmendën,
10 DW4-04 dhe DW4-06.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
12 është e nevojshme tani. Por dua që të dëgjojë mendimin tuaj
13 lidhur me pyetjen që nëse Mbrojtja ka materiale apo
14 informacione të tjera të disponueshme që kanë vlerë provuese
15 të cilat nuk janë të pasqyruara në përmbledhje. Për momentin
16 kjo është pyetja që ju drejtohet.

17 Nëse dëshironi mund ta përsëris pyetjen për Mbrojtjen,
18 për të qenë më konkrete. Pyetja është kjo: Në shënimet që keni
19 mbajtur pas takimeve me Dëshmitarin 06, a keni ndonjë
20 informacion tjetër shtesë lidhur me vendin se ku ndodhej ky
21 dëshmitar gjatë periudhës së aktakuzës? Pra, në shënimet
22 tuaja, a keni më shumë informacion lidhur me këtë pyetje që
23 sapo ju bëra?

24 Lidhur me Dëshmitar 04, kur ka qenë ai në Kukës? Pra,
25 përgjigjen e kësaj pyetjeje a e keni në shënimet tuaja, a keni

1 në përgjigje ose në shënimet tuaja ndonjë gjë që është më
2 konkrete?

3 Mund të shtoj më tej se lidhur me disa dëshmitarë, dhe në
4 qoftë se më kujtohen siç duhet, flitet për dëshmitarët 2, 3, 7
5 dhe 11 në listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes. Kur po lexonim
6 atë çfarë na keni parashtruar, pyetja që na doli ishte se kur
7 këta dëshmitarë kanë qenë, pra, në cilën kohë konkrete kanë
8 qenë këta dëshmitarë në fabrikën e përpunimit të metaleve në
9 Kukës. Pra, thjesht dua t'ju them që mbështetur në
10 përmbledhjen që na është dhënë për ne nuk ishte e qartë sepse
11 periudha e aktakuzës përfshin disa muaj, një periudhë të
12 shtrirë kohe.

13 Kështu që është e paqartë për neve se çfarë do të thonë
14 ata. Kështu që dua ta përsëris edhe një herë pyetjen. A ka
15 informacion tjetër me vlerë provuese që është në dispozicion
16 të Mbrojtjes, pra, informacion që e keni në shënimet tuaja që
17 ju mund ta ndani me neve?

18 Z. AOUIINI: [Përkthim] Po. Faleminderit, Znj. Gjykatëse.
19 Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë, përgjigja është "jo". Ne
20 ato që kishim nga shënimet që kanë vlerë provuese i kemi
21 dorëzu. Mund t'i shikojmë edhe një herë në qoftë se ka ndonjë
22 detaj.

23 Po në qoftë se marr një shembull, mund t'ju shpjegoj dhe
24 procesin e vendimmarrjes dhe pse bazuar në informacione jo të
25 detajuara i kemi përzgjedhur këta dëshmitarë, sepse është e

1 qartë. Pra, në qoftë se marrim dëshmitarin DW4-04 kuptojmë që
2 ky dëshmitar ka qenë pjesë e Brigadës 128, që është me interes
3 për neve. Nuk e ka pa të akuzuarin në Kukës, që është shumë e
4 rëndësishme për ne dhe kjo vlen edhe për një numër tjetër
5 individësh, disa prej të cilëve janë intervistuar nga ZPS-ja
6 dhe kanë thënë të njëjtën gjë. Dhe kemi vendosur që të sjellim
7 këto lloj provash përpara jush, znj. Gjyqtare.

8 Elementi tjetër shtesë që kemi për këtë individ dhe po
9 rikujtoj që i kemi takuar atë vetëm në vitin 2022 për një
10 periudhë shumë të shkurtër, jemi përpjekur që atëherë që ta
11 takojmë përsëri, të sqarojmë periudhën kohore, vendndodhjen e
12 individëve. Ky person na ka thënë neve, besoj që e kemi vënë
13 edhe në përmbledhje, se ishte kishte përgjegjësi disiplinore
14 pak a shumë dhe bëhet fjalë për procedura disiplinore ndaj
15 ushtarëve, që është e rëndësishme për ne, për Brigadën 128,
16 një individ që ishte përgjegjës për detyrat që kanë të bëjnë
17 me disiplinën.

18 Mund të shpjegojë çfarë ishte disiplina dhe të paraqesë
19 dhe ndaj pretendimeve të tjera, pra, ta paraqesë atë, sesi
20 funksiononte brigada.

21 Në qoftë se flasim për individë të tjerë nga e njëjta
22 brigadë, kuptojmë se qëndrimi jonë është që kjo brigadë ishte
23 vendosur në një pikë tjetër, pika 1; ne kemi pikën Buda. Kemi
24 shpjeguar më herët që në fillim të gjyqimit, se përbërja apo
25 individët që kanë qenë pjesë e kësaj brigade, nuk kanë qenë

1 shumë të mirëorganizuar në atë kohë dhe janë gjetur në front.

2 Pra, për sa i përket pretendimit që z. Shala ka qenë
3 anëtar i kësaj brigade apo ka luajtur ndonjë rol në këtë
4 brigadë apo ka qenë me individët që kanë qenë në brigadë qoftë
5 në pikën 1 ose në pikën 2, kjo do të kombinohet me dy
6 dëshmitarë të tjerë që kanë qenë të bazuar në fabrikën e
7 metalit në Kukës dhe të cilët e kanë parë Pjetër Shalën një
8 herë apo dy herë ose s'e kanë parë fare gjatë kohës që kanë
9 qenë të vendosur aty.

10 Pra, kemi dy grupe faktesh që janë nga brigada, faktin
11 nëse tani anëtarët e kësaj brigade dinë diçka për Pjetër
12 Shalën, kanë qenë aktivë në atë zonë për disa muaj deri në
13 çlirim, individët nuk kanë qenë pjesë e brigadës në vetvete
14 por nga pjesa e logjistikës, që kanë qenë të vendosur aty,
15 kanë fjetur aty dhe nuk e kanë parë Shalën.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit për këto sqarime, por pyetja ime ishte, është po
18 ashtu e rëndësishme relevante fakti që, kur, në cilin
19 periudhë, periudha kur këta dëshmitarë kanë qenë të pranishëm
20 tek fabrika metalit në Kukës dhe më saktësisht në raport me
21 periudhën e aktakuzës. Sepse është periudhë shumë e gjatë apo
22 jo. E gjatë është një fjalë relative.

23 Por kjo do të ishte pyetja të cilës nuk mund t'i marrë
24 përgjigje duke parë përmbledhjen ose përmbajtjen e
25 përmbledhjes.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Për, znj. Gjyqtare, është e qartë
2 që ata kanë qenë aty të pranishëm gjatë periudhës së aktakuzës
3 sepse në atë periudhë ka filluar të formohet brigada në pikën
4 1 dhe i gjithë qarku i anëtarëve të brigadës deri në Burrel ku
5 është dhe ngjarja, incidenti, ku kemi dhe një datë të saktë
6 për këtë, që më duket është data 1 maj, kanë qenë larg
7 Kukësit, pra dhe pastaj në front.

8 Por, në qoftë se na kërkoni që të rikthehemi
9 përmbledhjeve dhe të përpiqemi të gjejmë informacione më të
10 detajuara, për momentin këto janë informacionet që kemi ne nga
11 ato individë të cilët ishin aty në momentin kur ka filluar
12 mobilizimi. Kanë arritur aty në pika të ndryshme. Nuk kemi
13 data të sakta, por besojmë që kjo është saktësisht brenda
14 periudhës së aktakuzës kur njerëzit kanë filluar të
15 grumbullohen. Disa janë bashkuar më parë, disa më vonë, por
16 qëndrimi jonë është që ata pjesëtarë të cilët ne do t'i
17 thërrasim janë gjetur në Burrel në atë kohë dhe pastaj kanë
18 përfunduar në front.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
20 që dëgjoj është që ju jepni sqarime. Nga sqarimet tuaja marr
21 përshtypjen se ka informacione të tjera që janë të
22 disponueshme në shënime që japin më shumë qartësi për këto
23 përmbledhje. Këtë po përpiqem të them dhe kjo është besoj dhe
24 thelbi i asaj që po thonte ZPS-ja, të njëjtën gjë dhe
25 Mbrojtësi i Viktimave. Ju dëgjova që thatë më herët.

1 Por do t'ju sugjeroja që Mbrojtja, pra, të rishqyrtojë
2 edhe një herë shënimet e brendshme dhe të përpiqet të nxjerrë
3 nga ato, për aq sa është e mundur, informacione shtesë që t'ia
4 shtojë përmbledhjes, sepse me sa duket ju dini më shumë sesa
5 ne dimë dhe mbas sqarimeve që jepni ju na dhatë informacione
6 të tjera që me sa duket janë aty të disponueshme.

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, znj. Avokate [Shih kontekstin].
8 Gjendja është si në vijim. Ne jemi dakord nëse doni që të
9 vendosni pak detaje më shumë nga ajo që keni kuptuar nga
10 dëshmitarët --

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
12 pak më shumë. Pyetja ime do të ishte gjithçka që ju mendoni,
13 ju vlerësoni pra, sepse këtë jua lëmë juve, që mendoni ka
14 vlerë provuese, në qoftë se për marrjen e vendimit, pra, në
15 qoftë se dëgjohen dëshmitarët, qoftë për atë që ka ndodhur për
16 sa i përket marrjes, gjetjes së fakteve, por, gjithashtu edhe
17 për besimin e besueshmërisë. Kjo do të ishte ajo që donim.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, znj. Gjykatëse. Dhe kjo është
19 saktësisht arsyeja për të cilën kemi vendosur në përmbledhje
20 atë për të cilin jemi shumë të sigurtë. Individët kanë qenë
21 aty gjatë periudhës së mobilizimit, ndoshta përpara, ndoshta
22 prapa, po të venë data apo muaj në përmbledhje mund të duket
23 në mënyrë të padrejtë se ka mospërputhje, kundërshtime, nga
24 ato që dëshmitari të mund të sqarojë në Gjykatë.

25 Ne kemi vendosur data që mendojmë apo periudha që

1 mendojmë që përputhen nga ajo që kemi kuptuar nga individët,
2 por kjo nuk duhet të merret si diçka që dëshmitarët na kanë
3 thënë me saktësi me ato fjalë. Megjithatë, në qoftë se doni që
4 të shpjegojmë periudhat kohore, ne mund t'i sqarojmë. Jo sepse
5 nuk duam ta vëmë në përmbledhje, po ata kur i kemi takuar na
6 kanë thënë "Ne kemi qenë që nga fillimi", për shembull, pa
7 dhënë data apo ka qenë pika 1, për neve ka qenë një
8 informacion i mjaftueshëm për të përcaktuar që ata kanë qenë
9 aty që në fillim, individët që vijnë nga Kosova në Kukës.

10 Por, kjo nuk ka ndikim në vetvete për sa i përket
11 relevancës së këtyre individëve për neve sepse ishin pjesë e
12 brigadës në atë kohë kur kanë ndodhë ngjarjet në maj në Burrel
13 dhe pastaj në front, bombardimet dhe aspektet më të
14 rëndësishme të periudhës së aktakuzës pra.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Udhëzimi jonë, sepse tani e kemi diskutuar këtë, udhëzimi jonë
17 duhet të ishte për sa i përket kësaj që ju të vendosni në
18 përmbledhje, të fusni aty, atë të cilës mund t'i referoheni si
19 pjesë e asaj që ju ka thënë dëshmitari.

20 Në qoftë se nuk mund të na jepni një datë të saktë sepse
21 nuk e di atë, ju lutem, në këtë rast mos fusni asgjë të tillë
22 në përmbledhje. Natyrisht. Drejtohuni, ajo që do të bëni është
23 pra, që të njoftoni Trupi Gjykses, Prokurorinë dhe Mbrojtësin
24 e Viktimave për atë që dëshmitari ka thënë dhe mbi të cilën do
25 të japë dëshmi sa më saktë afër asaj që është thënë që është e

1 mundshme.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne e mirëpresim këtë udhëzim, e
3 kuptojmë, kjo nuk na vë neve në një pozitë të vështirë, nuk do
4 të vëmë fjalë në gojën e dëshmitarëve. Për këtë ne jemi
5 vetëpërmbytur nuk kemi vendosur, shkruar gjëra që mund të
6 ishin nxjerrë si të nënkuptuara.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Megjithatë, në të njëjtën kohë, ne duhet të jemi në gjendje që
9 të vlerësojmë relevancën, rëndësinë e dëshmitarëve të caktuar.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] E kuptoj, znj. Gjykatëse. Dhe ne do
11 të rishikojmë përmbledhjet që kemi dhënë. Edhe të shohim që të
12 përfshijmë aty dhe detaje të tjera, në qoftë dhe pa ndonjë
13 detaj tepër të saktë për sa përket datave, do të vendosim
14 gjithçka që është relevante, e rëndësishme. Nuk po fshehim
15 asgjë. Nuk po krijojmë situata surprizë për askënd. Po
16 kërkojmë informacione më shumë se dy dekada pas ngjarjeve.
17 Është ushtrim i vështirë që dëshmitarëve t'ju kujtohen këto
18 gjëra, ne jemi mjaftuar me informacionet që përfshijnë
19 periudhën për të cilën bëhet për ngjarjet.

20 Do të rishikojmë, pra dhe njëherë përmbledhjet dhe të
21 shohim nëse ka ndonjë material provues sa i përket kohës,
22 datave, vendeve që mund të përfshijmë aty. Faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
24 t'ju jap fjalën edhe një herë palëve, megjithatë dua të
25 falënderoj ekipin e Mbrojtjes për faktin që na ka informuar në

1 mënyrë të rregullt me kopje, na ka dhënë kopje dhe përmbledhje
2 të hetimit të tyre.

3 Znj. Prokurore, a keni diçka për të shtuar lidhur me këtë
4 aspekt?

5 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Znj. Gjyqtare, ne kemi
7 parashtrimet specifike lidhur me relevancën e dëshmitarëve.
8 Mirëpresim sqarime. Kuptojmë dhe vështirësitë. Besoj, që edhe
9 Mbrojtja duhet ta dijë për çfarë pritet që dëshmitarët do të
10 japin dëshmi sidomos kur bëhet fjalë për periudhën kohore dhe
11 relevancën. Megjithatë, për këtë aspekt nuk do them më shumë
12 tani.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy
14 pika, çështje këtu.

15 Vërejtja e ZPS-së për sa i përket dëshmitarëve në listën
16 e dëshmitarëve të Mbrojtjes. Do të bisedojmë, do të diskutojmë
17 këtë çështje të paraqitjes së rendit të paraqitjes së rendit
18 të paraqitjes së dëshmitarëve të Mbrojtjes pas urdhrin që do
19 të jap për paraqitjen e dëshmitarëve. Do t'i jap fjalën pastaj
20 edhe ZPS-së që të japë komentet e saj lidhur me dëshmitarët e
21 ndryshëm.

22 Tani, Mbrojtës, z. Avokat, kur mendoni sot që do të jeni
23 në gjendje të na i jepni informacione shtesë? Sepse janë të
24 rëndësishme për vendimin tonë, vendimet gojore që kemi në plan
25 t'i japim nesër. Do të na ndihmonte shumë në qoftë se do

1 ishiti në gjendje të na jepnit përmbledhje të përditësuarat sot
2 nga fundi i ditës.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Pengesa e vetme është kemi një
4 afat sot për të dorëzuar një parashtrim të protokolluar sipas
5 rregullës 103 se na merr shumë kohë dhe burime. Do të bëjmë
6 gjithçka që është e mundur që të plotësojmë këto përmbledhje
7 me informacione shtesë nga fundi i ditës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull. Është kërkesa nga rregulla 103, e kuptoj. Por,
10 megjithatë, kjo duhet të bëhet, do të thojë, do vlerësojë
11 shumë që të na i jepnit fillimisht përmbledhjet. Dhe pastaj që
12 të merreni me çështjen nga rregulla 103 nesër, besoj që do të
13 këtë mirëkuptim për këtë. Por lidhur me këtë pikë duhet të
14 shkojmë, duhet të vazhdojmë, nuk mund të ndalemi.

15 Dhe duhet që t'ju japë edhe ZPS-së dhe Mbrojtësit të
16 Viktimave mundësinë që të reagojnë lidhur me informacionet
17 shtesë që do të jepen, pra, do t'ju kërkoj juve - i drejtohet
18 Prokurorisë - që të jepni komentet tuaja në afate nesër në
19 mëngjes për shembull. Sepse nesër jemi në Gjykatë dhe besoj që
20 është e rëndësishme që duke pasë parasysh planifikimin e
21 paraqitjes së provave nga Mbrojtja që të fillojmë nga data 18
22 shtator.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Parashtrimet që synojmë të
24 dorëzojmë lidhur me relevancën e këtyre dëshmitarëve do të
25 ndihmojnë edhe Mbrojtjen lidhur edhe me informacionet shtesë

1 që mendojmë që janë të rëndësishme për të bërë një vlerësim të
2 relevancës.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. AOUBINI: [Përkthim] Kemi një propozim, një sugjerim,
6 znj. Gjykatëse.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju e
8 keni fjalën, z. Avokat.

9 Z. AOUBINI: [Përkthim] A do të ishte e mundur për neve që
10 mocionin sipas rregullës 103, që duhet ta dorëzonim sot, ta
11 dorëzojmë më vonë? Dhe që t'i japim përparësi absolute
12 përmbledhjeve që duhet të bëjmë sepse jemi në fazën ku pjesa e
13 ekipit që është duke u marrë me vlerësimin e provave dhe të
14 poshtëshënimeve, provat që kanë të bëjnë me përmbledhjet pra,
15 mund të shkarkojmë, të heqim këtë pjesë të punës nga stafi që
16 po merret me përmbledhjet.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
18 jepni pak kohë që të mendoj për afatet kohore. Por besoj që
19 është zgjidhje e mundshme.

20 Për momentin do vazhdojmë me Mbrojtësin e Viktimave, keni
21 diçka për të shtuar me këto shkëmbime?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, znj. Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit.

25 Tani do të kalojmë tek rendi i paraqitjes së

1 dëshmitarëve.

2 Tani, lidhur me kërkesën sipas rregullës 130 që duhej për
3 sot, në qoftë se shkurtojmë afatin kohor për Mbrojtësin e
4 Viktimave dhe ZPS-në a është e mundur nga ana juaj?

5 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kuptoj që bëhet fjalë, znj.
7 Gjykatëse, për kohën që na jepet neve për t'u përgjigjur?
8 Natyrisht që duhet të jemi sa më bashkëpunues që është e
9 mundur që të jemi dhe efikas. Kjo varet nga mocioni për të
10 cilin po flasim, sa e gjatë është, sa e vështirë është, do të
11 përpiqemi, znj. Gjykatëse.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
13 tani është mjafton kështu.

14 Z. LAWS: [Përkthim] Qëndrimi është i njëjtë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit për këtë frymë bashkëpunimi të gjithëve.

17 Shoh që, z. Avokat, është në këmbë.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Kemi një sugjerim shtesë për
19 rregullin 130. Në momentin që do ta dorëzojmë, do të dorëzojmë
20 një kopje për të gjithë, në pritje të shpërndarjes zyrtare,
21 pra, se dihet se do bëhet të nesërmen me qëllim që ta kenë sa
22 më herët. Në qoftë se kjo mund të ndihmojë, ne do ta bëjmë
23 këtë gjë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndaj
25 dhe afatet kohore nuk do të ndryshojnë, por do të kemi pak më

1 pak kohë për ta bërë këtë.

2 Në rregull. Kalojmë tek pika e radhës në rendin e ditës,
3 rendi i paraqitjes së dëshmitarëve.

4 Mbrojtja parasheh që të thërrasë dëshmitarë më datën
5 gjashtë dhe shtatë.

6 Ju keni parashikuar që të thërrisni vetëm një dëshmitar,
7 për grupin e dëshmitarëve në grupin gjashtë dhe vetëm më 20
8 shtator. Besoj që e imagjinoni se ç'a do të them tani.

9 Më kujtohet që në mënyrë të përsëritur kam dhënë udhëzime
10 të gjithë palëve, që për aq sa është e mundur dhe e
11 parashikueshme, datat e seancave të parashikuara të mos ngelin
12 bosh që të përdoren. Kemi kohë të mjaftueshëm në Gjykatë,
13 sepse këtë sallë gjyqi e ndajmë me panelet e tjera, trupet
14 gjykues të tjera. Dhe kjo është koha që e kemi duhet ta
15 përdorim sa më shumë që të jetë e mundur.

16 Dhe është arsyeja e rëndësishme, për të cilën nuk kam as
17 dyshim që e keni parasysh edhe ju, është që kemi dhe të i
18 akuzuarin në paraburgim, pra, që duhet ta kemi parasysh në
19 përdorimin e datave të caktuara.

20 Pyetja ime është: A do të jetë Mbrojtja në gjendje që të
21 thërrasë dëshmitarin për më 18, dëshmitar tjetër? Si vazhdim i
22 kësaj çështjeje paraprake, pra, a keni bërë ndonjë përpjekje
23 për të thërritur dëshmitar për dy ditët e para?

24 Z. AOUINI: [Përkthim] E kuptojmë edhe ne nevojën për të
25 përdorur ditët e caktuara, po punojmë në këtë drejtim që të

1 jemi në gjendje të fillojmë. Që ditën e parë të kemi
2 Dëshmitarin 6, i cili është parashikuar paraprakisht më datën
3 18, por jemi gjetur para këtyre problemeve shëndetësore. Ka
4 probleme që ka, ka takime mjekësore për atë ditë, se dhe kjo
5 ka ndryshuar programin, pra, më duket se ditën përpara se të
6 dorëzojmë listën tonë.

7 Ai është angazhuar që të udhëtojë me makinë për të marrë
8 pjesë, por nuk e kemi akoma datën kur ai do të mbërrijë këtu.
9 Na ka thënë që është i gatshëm të udhëtojë qoftë edhe më datë
10 18 në darkë, në mbrëmje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
12 kuptoj shumë mirë këtë dhe nuk kam problem që të fillojmë të
13 mërkurën me këtë dëshmitar fare, qoftë edhe të enjten. Se në
14 parim jua lë Mbrojtjes, ekipit të Mbrojtjes, që të bëjë
15 planifikimin. Megjithatë, nuk dua që të kem vetëm një
16 dëshmitar gjithë atë javë, sepse do të thotë që do ngelim pa
17 përdorur sallën e gjyqit për një pjesë të javës. Kemi 17
18 dëshmitarë, unë e di që do dorëzoni edhe kërkesa, ndoshta nuk
19 do t'i kemi të gjithë këtu në Gjykatë sepse pres kërkesa nga
20 ju që do të dëgjohen në mënyrë tjetër, të merret dëshmia e
21 tyre në forma tjera. Por do shpresojmë që të ishim më efikas.

22 Z. AOUBINI: [Përkthim] Po, znj. Gjykatëse. Nuk kemi qenë
23 në gjendje që të vendosim dy dëshmitarët nga grupi i shtatë
24 sepse kemi frikë për çështjet që ndërlidhen me vizat e
25 pasaportave dhe për këtë arsye e kemi përdorur e kemi përdorur

1 një qytetar evropian për fillim. Ka një mundësi që të kemi një
2 dëshmitar që të përfshihet një ose dy ditë, Dëshmitari DWŞ-04,
3 i cili është i disponueshëm, por në këtë fazë nuk e dimë se ç
4 i duhet atij dhe për sa i përket aspekteve logjistike.

5 Ne mund të pretojme që do të përpiqemi maksimalisht që
6 të kemi edhe atë dëshmitar pra, mund të përpiqemi që të kemi
7 Dëshmitarin DW04-06, që të fillojë, po nuk mund të pretoj që
8 do t'ia arrijmë, znj. Gjykatëse. Është fatkeqësi. Po ashtu kjo
9 është maksimumi që mund të bëjmë, më kuptoni. 17 Dëshmitarë
10 vetëm disa prej tyre mund të paraqiten vetë të vijnë vetë,
11 pra, këtu. Dhe kjo është arsyeja pse kemi filluar me
12 Dëshmitarin 6 dhe pastaj dy dëshmitarë. Kemi tre ditë për
13 seancën më 23 tetor në të cilën, pra, qëllimi jonë është që
14 t'i fusim në grup që të jemi të sigurtë që të ndodhë që të mos
15 kemi surpriza. Megjithatë, do të përpiqemi që të plotësojmë
16 ato ditë me dëshmitarë dhe do t'ju informojmë nëse se arrijmë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 dëgjova që përmendët probleme me vizat, pasaportat. Mund të
19 përpiqeni që t'i sillni përpara. Nesër, në parim Trupi Gjykses
20 do të vendosë, do të informoheni për qëndrimet tona lidhur me
21 këtë. Ndoshta duhet që të këmbëngulni pak dhe të përshpejtoni
22 procesin.

23 Megjithatë jua lë juve këtë, që të organizoni gjithë
24 këtë.

25 Po, z. Avokat i Mbrojtjes, z. Gilissen. Keni fjalën juve.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Një prej vështirësive të vërteta
2 është që ne nuk jemi gjykatës, nuk jemi prokurorë, nuk kemi
3 polici. Dhe për këta persona në Kosovë, kjo është shumë e
4 rëndësishme. Janë shumë hezitues edhe në rastet kur pranojnë,
5 po e them në thonjëza "të merren me neve" ndihen të lirë.
6 Domethënë, ndodhë që bëjmë një takim, pastaj nuk vijnë. Kemi
7 takime të parashikuar të programuara, nuk vijnë. Herën e
8 fundit ishim në Prishtinë për të takuar një person të caktuar
9 dhe ditën kur shkua na tha "Kam një dasmë". Ne i thamë "Çfarë
10 dasme? Kemi takim". Tha "O është dasma e vajzës time". "Pra"
11 ne i thamë "po ju e dinit këtë gjë". Pra, këto janë llojet e
12 vështirësive me të cilat përballemi.

13 Më besoni jemi përpjekur maksimalisht. Me gjithë mend.
14 Ata kanë frikë qartësisht. Nuk janë të bindur që të
15 bashkëpunojnë. Pra, është një punë që kërkon shumë diplomaci,
16 është shumë e vështirë.

17 Jemi përpjekur me dëshmitarët në grupin e parë që t'i
18 kemi, jemi përpjekur. Do të përpiqemi prapë. Po është shumë e
19 vështirë. Besoni nuk është zgjidhje jonë, nuk është që kemi
20 vendosur ne kështu por është shumë e vështirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit për këtë sqarim.

23 Për sa i përket vizës, ju lutem do të thoja komunikoni me
24 Zyrën e Administratores, që ndoshta jam i sigurtë që ata do
25 t'ju ndihmojnë për aq sa kanë mundësi t'ju ndihmojnë.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Ne i kemi dërguar
2 formularët tek Zyra e Administratores dhe pas kësaj seance do
3 jemi duke punuar, duke u marrë me këtë çështje.

4 Dhe, siç e tha z. Gilissen do përpiqemi përsëri. Ky
5 individ, është i vetmi individ, pra, DW4-01 i cili mund të
6 plotësojë ato ditë. Dhe në qoftë se arrijmë ta kemi të
7 disponueshëm për ato ditë nuk do hezitojmë për asnjë çast
8 sepse është në interes të përbashkët të të gjithëve që të
9 përmbushim ditët dhe të ecim më tej sa më në mënyrë sa më të
10 qetë e më të mirë që është e mundur.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit. Atëhere vazhdojmë më tej.

13 Tani do të diskutojmë dëshmitë që pritet të jepen nga
14 dëshmitarët e propozuar nga Mbrojtja.

15 Avokat Mbrojtës, tani jemi në seancë publike. Parashikoj
16 që do të flasim, të shqyrtojmë listën e dëshmitarëve. Mendoj,
17 ndoshta është më mirë të kalojmë në seancë private, në qoftë
18 se do hyni në detaje, në qoftë se më thoni që mund të bisedoni
19 gjithçka në publik për sa i përket dëshmitarë atëherë dhe për
20 mua është në rregull. Por doja të kisha qëndrimin tuaj,
21 mendimin tuaj lidhur me këtë.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Mund të fillojmë në seancë publike
23 duke folur për aspektet logjistike dhe faktet të cilat nuk
24 janë identifikuese për asnjë. Dhe në qoftë se ka nevojë që të
25 hyjmë në detaje, në hollësi, atëherë mund ta bëjmë këtë në

1 seancë private së bashku, në qoftë se pajtoheni edhe ju.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë. Mënyra sesi do vazhdojmë është do bëjmë një xhiro, pra,
4 të ZPS-së, Mbrojtësit të Viktimave.

5 Znj. Prokurore apo z. Prokuror, më duket që ju do jepni
6 disa qëndrime, vlerësime shtesë apo do flisni lidhur me
7 informacionin që mungonte për vlerësim të mëtejshëm të
8 dëshmitarëve.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me sa kuptoj unë do të kalojmë
10 në listë një për një. Në qoftë se do të bëhet kështu atëherë
11 do t'i japim përgjigjen Palës Mbrojtëse pasi t'i kenë bërë
12 parashtrimet shtesë dhe pastaj ne mund të përgjigjemi. Ose
13 mund të flas që tani, mund të jap vëzhgimet e mia që tani
14 lidhur me dëshmitarët që janë në listën e dëshmitarëve. Jo për
15 të gjithë. Po për disa.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
17 mendoj se do të ishte më mirë ta bënim ashtu, pasi mund të
18 ndihmojmë Palën Mbrojtëse në kohën që shqyrtojmë shënimet e
19 tyre. Dhe tani që po flasim së bashku, kam edhe listën e
20 pyetjeve dhe do të verifikojmë nëse behet për të njëjtën listë
21 me qëllim që të mos dublikojmë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dakord.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Avokati Mbrojtës, t'i kthehem tani çështjes që i kemi
25 diskutuar për vështirësitë që keni për të sjellë dëshmitarët

1 këtua në kohën e duhur. Ju mund të shqyrtoni mundësinë e një
2 seance me videolidhje, nëse ka probleme me pasaportën apo me
3 vizën. Në qoftë se ata dëshirojnë dhe janë të gatshëm. Ju e
4 dini se ku ndodhen ata. Ne kemi parë që edhe kjo është diçka e
5 mundur. Dhe po e paraqes si mundësi që mund të zgjidhë disa
6 nga problemet tuaja.

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Dhe
8 prandaj dëshmitari DW4-01 është dhe shansi më i mirë për t'i
9 mbushur këto që i kemi dhe për të tejkaluar këto vështirësi
10 logjistike.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Prokuror, e kam shfrytëzuar këtë kohë për të diskutuar këtë
13 çështje me Palën Mbrojtëse.

14 Ju e keni fjalën.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

16 Rregulla 137 përdoret për të treguar, për të dhënë dëshmi
17 të tjera në këtë çështje. Dhe për sa i përket rregullës
18 143(4), pyetjet duhet të jenë me vlerë për të gjetur të
19 vërtetën dhe për të shmangur harxhimin e kohës dhe burimeve.

20 Dhe ne mendojmë, që një numër i madh dëshmitarësh të
21 paraqitur nga Pala Mbrojtëse nuk janë dëshmitarë me vlerë ose
22 vlera e tyre nuk mund ose vlera e dëshmisë së tyre nuk mund të
23 shikohet pa dëshmi të tjera.

24 Për disa nga këto dëshmitarë informacioni është kaq i
25 vogël a i pakët sa të mos mund të bëhet dot vlerësimi lidhur

1 me vlerësinë e tyre. Dëshmitarët të cilët nuk kanë qenë në
2 fabrikën e metalit në Kukës në kohën e aktakuzës janë të tillë
3 dhe kjo ndikon pikërisht në këtë vlerësim.

4 Dhe e fundit, nuk është e qartë se çfarë vlere dëshmuese
5 do të nxjerrë Pala Mbrojtëse nga këtë dëshmitarë dhe ne do të
6 kërkonim që të sqaroheshin për të parë se cilat janë
7 argumentet e Mbrojtjes në këtë.

8 Unë do paraqes vetëm listën e dëshmitarëve, vlerën
9 dëshmuese të cilëve duam të diskutojmë.

10 I para është numri 2 në listën e tyre, Dëshmitari 4454.

11 Bazuar mbi informacionin që na është dhënë, që janë
12 dëshmitë e ZPS-së, dëshmitari nuk ka qenë në fabrikën e
13 metalit në Kukës në kohën e aktakuzës. Me sa kuptojmë ne, ai
14 ka shkuar në Burrel në fund të prillit 1999, ku ka qëndruar
15 për dy javë. Në mes të majit, është kthyer në Kukës, ku
16 qëndroi për një periudhë një javë, po qëndroi në pikën 1 që
17 është larg fabrikës së metalit në Kukës dhe disa qindra metra
18 deri në një kilometër. Dhe gjatë asaj periudhe të aktakuzës
19 nuk është kthyer në fabrikën e metalit në Kukës.

20 Kështu që ne e hedhim poshtë sesa i rëndësishëm është ky
21 dëshmitar pa dokumentet e tjera mbështetëse.

22 Numër 3 në listën e dëshmitarëve është DW4-02. Nga
23 përmbledhja që na është dhënë nga Pala Mbrojtëse edhe ky
24 dëshmitar ka qenë në vilën 1. Jo në fabrikën e metalit në
25 Kukës. Kështu që, mundësia e tij për të dhënë dëshmi lidhur me

1 krimet e pretenduara të cilat kanë ndodhur në vilën apo
2 ndërtesën 2, është e paqartë. Duke patur parasysh këto dëshmi
3 që janë dhënë, ne mendojmë që është e pavlerë.

4 Pala Mbrojtëse dëshiron që të nxjerrë nga ky dëshmitar
5 dëshmi lidhur me rëndësinë e UÇK-së në Kukës. Për ne, kjo
6 është e parëndësishme. Pasi i takon Prokurorisë që të ketë
7 barrën të provojë rëndësinë e kësaj çështjeje kontekstuale dhe
8 është e paqartë se çfarë dëshiron të nxjerrë Mbrojtja përmes
9 pranisë së këtij dëshmitari në Brigadën 128. Dhe ne do i
10 kërkonim sqarime të mëtejshme.

11 Një dëshmitar tjetër është numri 7 në listën e tyre, DW4-
12 04. E kemi përmendur, por nuk ka informacion se kur ka qenë në
13 Kukës ky dëshmitar dhe ku, ishte në ndërtesën 1, në ndërtesën
14 2, ku? Apo nuk ka qenë fare. Dhe të njëjtat konsiderata që
15 kishim për dëshmitarët e tjerë vlejné edhe për këtë.

16 Dhe ne do të mendonim që Pala Mbrojtëse do ta dijë se ku
17 ka qenë ky dëshmitar përpara se thërrasë për të dhënë dëshmi.
18 Ne nuk e pranojmë një parashtrim që thotë që "Ne nuk jemi të
19 sigurtë, nuk e dinim". Në qoftë se ato e dinë që një dëshmitar
20 ka qenë atje dhe mund të japë dëshmi, atëherë pyetja do të
21 ngrihet nëse ky dëshmitar duhet thirrur apo jo për të dhënë
22 dëshmi. Pala Mbrojtëse duhet ta dijë se kjo nuk është çështje
23 fati nëse një dëshmitar ka apo nuk ka dëshmi për të dhënë. Dhe
24 në qoftë se një gjë e tillë është e vërtetë atëherë duhet që
25 ata të përmirësojnë edhe përmbledhjet që na kanë dorëzuar.

1 Për sa i përket dëshmitarit 12 në listën e tyre,
2 Dëshmitari DW4-06. Siç e tha kolegja ime, ne duam të dimë
3 informata të mëtejshme lidhur me vendndodhjen e tij në kohën e
4 duhur. Ne nuk mund të presim që këtë të na e tregojë në sallën
5 e gjyqit. Ne besojmë që Pala Mbrojtëse, do të ketë diskutuar
6 se ku ka qenë dëshmitari në atë kohë dhe duhet ta kenë këtë
7 informacion. Në qoftë se nuk e kanë këtë informacioni, ne do
8 t'i kërkonim Palës Mbrojtëse që ta kërkojnë këtë informacion
9 nga dëshmitari.

10 Deklaratat e përgjithshme që "dëshmitarët do të na japin
11 në kontekst apo informacion historik" janë shumë të
12 përgjithshme dhe nuk na mundësojnë që të vlerësojmë sesa me
13 vlerë do të jenë këta dëshmitarë.

14 Dhe çështja e fabrikimit të çështjes nga shërbimi sekret
15 serb nuk është me vlerë. Në qoftë se ne nuk e kuptojmë se
16 ç'dëshmi do të japë dëshmitari lidhur me akuzat e kësaj
17 çështjeje dhe me argumentin që ka paraqitur ZPS-ja deri më
18 tani.

19 Ne po kështu kundërshtojmë, të nderuar Gjykatës dhe
20 dëshmitarët 14, 15 dhe 16 në listën e dëshmitarëve. Pala
21 Mbrojtëse dëshiron që të sjellë dëshmi lidhur me ngjarjet që
22 kanë ndodhur pas periudhës së aktakuzës.

23 Ne e kuptojmë që ata duan të flasim mbi një temë të
24 caktuar, [REDAKTUAR]
25 [REDAKTUAR]. Por, vetëm njëri nga dëshmitarët që dëshiron

1 të sjellë, që do të sjellë Pala Mbrojtëse këtu, Dëshmitari
2 DW3881, ka marrë pjesë në këtë operacion, dy të tjerët jo.
3 Njëri prej tyre ka shkuar thjesht për ta marrë njërin prej
4 dëshmitarëve dhe për ta dërguar në spital.

5 Pala Mbrojtëse do të duhet të tregojë më në hollësi se
6 çfarë do të nxjerrë nga dëshmitarët. Pasi, aktualisht, me
7 informacionin që kemi, ne mendojmë që kjo është pa vlerë. Ne i
8 kemi parë deklaratat e këtyre dëshmitarëve për të kuptuar pak
9 shumë dhe ne nuk e kuptojmë sesi përputhet dëshmia e këtyre me
10 ngjarjet.

11 Në qoftë se një dëshmitar thirret për të dhënë dëshmi
12 lidhur me dëshmitarët e ZPS-së, atëherë duhet ta sqarojë këtë
13 Pala Mbrojtëse, për të bërë fjalë se për çfarë dëshmie bëhet
14 fjalë, për cilin dëshmitar të ZPS-së.

15 Kemi pastaj dëshmitarë të cilët do të dëshmojnë për
16 situatën në Kosovë, [REDAKTUAR]
17 [REDAKTUAR]. Të nderuar Gjykatës, si është me vlerë kjo dhe
18 ç'lidhje ka me pikat e aktakuzës së kësaj çështjeje gjyqësore.
19 Nuk ka vlerë.

20 Dhe, si përfundim, W4751. Pala Mbrojtëse dëshiron ta
21 paraqesë këtë sipas rregullit 155. Ishte ky një dëshmitar i
22 listës së Prokurorisë.

23 Siç e thashë dhe më parë, i takon barra Prokurorisë për
24 të provuar disa elementë dhe ne mendojmë që ky dëshmitar do të
25 mund të flasë lidhur me këtë çështje, lidhur me organizimin,

1 me faktin që UÇK-ja ka qenë një grup i organizuar dhe se
2 fabrika e metalit në Kukës është shfrytëzuar për disa synime
3 të caktuara. Por është ky dëshmitar i cili është larguar nga
4 Kukësi në fund të prillit të vitit 1999.

5 Nga përmbledhjet që na ka dorëzuar Pala Mbrojtëse është e
6 paqartë se ç'dëshmi do të japë ky dëshmitar për të mbështetur
7 argumentet e tyre. Ne mund të bëjmë parashtrime me shkrim
8 lidhur me këtë çështje në qoftë se dërgon mocion Pala
9 Mbrojtëse. Kjo është e vërtetë, por me megjithatë do ta thoja
10 paraprakisht se jemi të çuditur sesi mund të jetë ky një
11 dëshmitar i cili të mbështesë argumentet e Mbrojtjes.

12 Kundërshtimi, të nderuar Gjykatës, lidhur edhe me tre
13 ndërkombëtarët e propozuar nga Pala Mbrojtëse me të cilën kanë
14 kërkuar që të -- edhe të përmirësojnë listën e provave
15 materiale nuk është e qartë për ne. Një nga këto prova
16 materiale përmend dy dëshmitarë që ZPS-ja pretendon që janë
17 ndaluar në Kukës, po është në raport që ka të bëjë me
18 vendndodhjen e këtyre dëshmitarëve, në qershor të vitit 1999.
19 Pas periudhës së aktakuzës, [REDAKTUAR]
20 Pra, thjesht fakti që i përmend dy personat e interesuar të
21 kësaj çështjeje penale, nuk e bën këtë që të jetë një dokument
22 me vlerë, sipas mendimit tonë, e nderuar Gjykatëse.

23 Dhe ky është edhe parashtrimi që kemi ne me vlerën për të
24 thirrur disa dëshmitarë apo jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit, z. Prokuror.

2 Përpara se të t'ia jap fjalën, Palës Mbrojtëse.

3 Mbrojtës i Viktimave, dëshironi të bëni ndonjë koment
4 lidhur me këtë çështje?

5 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Ne i
6 mbështesim parashtrimet e paraqitura nga ZPS-ja dhe nuk kemi
7 gjë me vlerë për të shtuar.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Pala Mbrojtëse, përpara se t'ju jap juve fjalën, përveç
11 asaj që është thënë deri më tani, Trupi Gjygues dhe po i
12 kthehem asaj që përmenda më herët. Duam të dimë që për sa u
13 përket dëshmitarëve 2, 3, 7 dhe 11 në listën tuaj të
14 dëshmitarëve, Trupi Gjygues dëshiron të dijë se kur kanë qenë
15 në fabrikën e metalit në Kukës këta dëshmitarë gjatë periudhës
16 së aktakuzës dhe duam të dimë datën e saktë, nëse është e
17 mundur.

18 Pra, ato kanë qenë në fabrikën e metalit në Kukës gjatë
19 gjithë kohës që përfshinë aktakuza dhe kur ekzaktësisht.

20 Kam disa pyetje të cilat janë përsëritur por nëse
21 dëshironi të reagoni tani, e keni fjalën.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
23 Dëgjua kolegët e ZPS-së që janë të çuditur nga informacioni i
24 paktë. Edhe ne po ashtu ishim të hutuar nga informacioni i
25 pakët që na kanë paraqitur ata gjatë argumenteve të tyre dhe u

1 përpoqëm që ta trajtonim situatën në bazë të asaj.

2 E kemi thënë qartësisht që z. Shala ishte akuzuar se
3 ishte pjesë e Brigadës 128. Ne po sjellim njerëz për të
4 treguar që ai, z. Shala, nuk ka qenë në Brigadën 128. Ne po
5 sjellim njerëz që të thonë që nuk e kanë pa z. Shala atje.

6 Ne po përpiqemi të luftojmë kundër argumenteve që z.
7 Shala ka qenë atje apo që ka mbajtur ndonjë rol në fabrikën e
8 metalit në Kukës apo që ka qenë në marrëveshje me individë të
9 tjerë për të kryer vepra penale. Dhe kjo është arsyeja përse
10 po sjellim njerëz nga Brigada 128, për të provuar këtë.

11 Siç e tha z. Gilissen në fjalën hyrëse, z. Shala nuk ka
12 patur vend në fabrikën e metalit në Kukës dhe ne po përpiqemi
13 të provojmë pikërisht një gjë të tillë. Të nderuar Gjykatës,
14 ju do ta kuptoni që shumica e dëshmitarëve janë dëshmitarë të
15 marrë në pyetje nga ZPS-ja. Dhe prandaj po kërkojmë që të
16 vijmë ata për të dhënë dëshmi, pasi duam që të dalë e vërteta,
17 duam të tregojmë që ka ekzistuar ky informacion kur kanë
18 formuluar aktakuzën ZPS-ja dhe kjo është me vlerë është me
19 vlerë shumë të madhe për këtë çështje.

20 Bëhet fjalë për një individ që ka qenë atje, i cili ka
21 thënë që "Ka qenë gjatë gjithë kohës deri në çlirim" dhe do të
22 shpjegojë se kush ka qenë kjo brigadë, kush kanë qenë njerëzit
23 të cilët kanë qenë aty. Ky është në listën tonë numri 3, e
24 nderuar Gjykatëse. Dhe, siç e kemi thënë në përmbledhje, në
25 përmbledhjen që kemi dorëzuar, kemi paraqitur se kush është

1 kjo klinikë e improvizuar në këtë ndërtesë të oficerëve dhe do
2 të mund të shihet sesa pak objekte ka patur aty në atë moment.

3 Ne po sjellim një dëshmitar i cili ka të bëjë me
4 disiplinën dhe jemi të bindur që në qoftë se vjen ky dëshmitar
5 ai do të shpjegojë se ka qenë pjesë e asaj brigade, brigadë e
6 cila është formuar përpara mobilizimit të përgjithshëm dhe që
7 ka përfunduar në Prizren pas çlirimit. Çdo gjë që ka ndodhur
8 me këtë brigadë është me vlerë edhe në qoftë se nuk e kemi të
9 gjithë informacionin, jemi të bindur që po t'ju bëjmë pyetje
10 këtyre këtu në sallën e gjyqit do të jetë me vlerë. Siç e
11 thotë kolegu im, nuk është e rëndësishme që dikush nuk e njeh
12 z. Pjetër Shala. Por kanë qenë në brigadë dhe, për shembull,
13 personi numër 17.

14 Një nga çështjet të cilat dëshmon ai, për të cilën
15 dëshmon ai është se s'e thotë që nuk është pyetur fare për z.
16 Shala. Pra, komandanti i brigadës nuk është pyetur fare për
17 Pjetër Shalën. Është një dokument të cilin e ka nënshkruar
18 shefi i një ministrie, vërtetësinë e të cilit ai e hedh
19 poshtë. Dhe bëhet fjalë për vërtetësinë e këtij dokumenti që
20 thuhet që e ka emëruar z. Pjetër Shala që të shkojë në Kukës.

21 Dhe ne po luftojmë këto pretendime që thoni që z. Shala
22 ka qenë në Kukës, ai nuk ka qenë atje. Ka qenë në front duke
23 luftuar në emër të kombit të tij. Dhe ne kemi bërë të qartë
24 argumentin tonë në mbrojtjen e z. Shala kur kjo është treguar
25 se është e nevojshme.

1 Pjesa tjetër logjistike është dëshmitarët që janë
2 tërhequr nga ZPS-ja. Ekziston një person i cili ka patur
3 filmime mbi ngjarjet që kanë ndodhur në atë kohë dhe po
4 kërkojmë që të vijë ai për të dhënë dëshmi. Dhe ka qenë një
5 person që ka qenë atje gjatë gjithë kohës e ka takuar z. Shala
6 dhe do të shpjegoj se në cilin kontekst kur e ka parë dhe kur
7 e ka parë herën tjetër. Dhe këto janë të gjitha me vlerë shumë
8 të madhe, e nderuar Gjykatëse.

9 Individët e tjerë si DW4-01 kundërshton pretendimet të
10 cilat ne i kemi paraqitur gjatë kundërpyetjeve tona. Dhe ju e
11 keni tematikën të cilën do ta diskutojmë në atë pikë ky
12 dëshmitar.

13 Për sa i përket dëshmitarit DW4-06, ne e kemi
14 informacionin me vlerë dhe do ta nxjerrim për të gjithë. Ky
15 person thuhet që ka qenë në fabrikën e metalit në Kukës mes
16 zyrtarëve të lartë. Është ky një dëshmitar i cili përmend
17 pothuajse të tërë elitën politike të Kosovës të cilët kanë
18 shkuar në Kukës për ta rrahur atë dhe ky është W04733. Dhe ne
19 kemi një individ i cili nuk ka qenë fare në Kukës dhe ne kemi
20 nxjerrë dy certifikata që tregojnë që nuk ka hyrë në Shqipëri.
21 Kjo mjafton për ne dhe është me shumë vlerë për argumentet
22 tona.

23 Dhe ne do të provojmë një gjë të tillë bashkë me numrin 6
24 në listën tonë, që është W04441 dhe numër 10 në listën tonë,
25 që është 04440. Janë dëshmitarë të cilët kanë patur një rol

1 penal apo jo në fabrikën e metalit në Kukës, janë persona të
2 cilët nuk kanë qenë fare në Shqipëri apo në Kukës dhe këto
3 janë çështje të kredibilitetit të këtyre dëshmitarëve. Dhe ne
4 kemi të drejtë të paraqesim argumentet tona për t'i
5 kundërshtuar këto. Ne nuk po i sjellim që të gjithë që të
6 japin dëshmi këtu në sallën e gjyqit. Megjithatë ajo që kanë
7 deklaruar përpara ZPS-së ka vlerë shumë të madhe për sa i
8 përket z. Shala dhe për ne për të provuar sesa të besueshëm
9 janë këto dëshmitarë.

10 Tani, për sa i përket ndërkombëtarëve. Të nderuar
11 Gjykatës, gjatë kundërpyetjeve kemi parashtruar se do të
12 sjellim dokumente për të provuar disa ngjarje të caktuara dhe
13 kjo ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me besueshmërinë e
14 individëve dhe të rrëfimeve që janë treguar gjatë çlirimit që
15 [REDAKTUAR]. Ne do të tregohemi të
16 hapur. Me kemi një [REDAKTUAR], dhe
17 ne do të parashtrojmë që personat të cilët kanë marrë pjesë të
18 drejtpërdrejtë, fizikisht apo duke u nënshkruar, duke
19 nënshkruar apo [REDAKTUAR]
20 [REDAKTUAR] do të
21 paraqesim çdo para jush, të nderuar Gjykatës, me qëllim që ta
22 keni të tërë pasqyrën.

23 Ne do të argumentojmë përmes paraqitjes së përgjithshme
24 të situatës se çfarë mund të ketë qenë e vërtetë apo jo. Dhe
25 këta persona janë ndërkombëtarët të cilët do të japin dëshmi

1 sesi ka qenë situata në atë kohë dhe çfarë mund të besohet dhe
2 çfarë jo. Ndoshta ata mund të na tregojnë dhe nuk do ta them
3 në publik, të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
5 të kalojmë në seancë private atëherë.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Këta do të thonë se kur janë takuar
7 me individët e përmendur dhe të cilën e kemi dëgjuar përmes
8 dëshmitarëve. Unë mund të shpjegoj më tutje, e nderuar
9 Gjykatëse, por këtu bëhet fjalë për besueshmërinë e dëshmive
10 që kemi dëgjuar dhe që ne besojmë që ZPS-ja ka patur dijeni,
11 shpjegimet nganjëherë janë shumë të ndryshme nga realiteti.
12 Dhe ne prandaj duam të paraqesim këtu para, të nderuar
13 Gjykatës.

14 Dhe për sa i përket organizimit të UÇK-së apo organizatës
15 së UÇK-së, sipas nesh ajo që është paraqitur nuk është e
16 vërtetë. Ajo kërkon për detyrë të provojnë çdo gjë, por ne do
17 të paraqesim që organizimi i tyre nuk është siç është
18 realiteti. Realiteti në atë kohë ka qenë që janë mbledhur disa
19 civilë së bashku për të luftuar në emër të vendit të tyre. Dhe
20 kjo vlerë edhe për Brigadën 128.

21 Është një numër faktorësh që ata të arrijnë në çlirim.
22 Por niveli i organizimit të atëhershëm nuk mbështet argumentin
23 që tregon që ka ekzistuar një armatë apo ushtri e rregullt si
24 ajo që kanë patur serbët.

25 Dhe kjo është çështje kyçe për ne. Disa nga këta individë

1 do të vijmë për të folur për rrethanat dhe është një nga
2 çështje që i ka nënvijëzuar në mënyrë të saktë z. Gilissen në
3 fjalën hyrëse. Këta janë viktimat. Këta janë të torturuar.
4 Këta janë të dëbuarit. Të cilëve u është dashur që të luftojnë
5 me mjete të pamjaftueshme. Kjo është situata dhe konteksti që
6 duhet parë dhe duhet thënë kjo pikërisht në kontekstin e
7 aktakuzave për Republikën e Kosovës.

8 Dhe ky është roli që ka luajtur z. Shala. Nuk bëhet fjalë
9 për rrahjen e individëve. Në qoftë se dikush ka bërë rrahje të
10 tilla apo trajtime të tilla, kjo është bërë nga disa individë
11 të veçantë.

12 Dhe, e nderuar Gjykatëse, gjëja e fundit që kam për të
13 përmendur është barazia mes palëve. Është pikërisht për shkak
14 të këtij parimi që ne i kemi paraqitur këta persona të cilët
15 nuk deshën që të takoheshin me ne. Ne thjesht për barazi, për
16 parimin e barazisë, ne i kemi vendosur deklaratat e tyre. Ne
17 nuk po lozim Poker këtu. Në qoftë se nuk merrni vërtetësinë e
18 deklaratave të tyre, atëherë do të shihni se kjo është dëshmia
19 që kanë dhënë para ZPS-së dhe duhet të merren parasysh këto
20 dëshmi të tyre kur vlerësoni krimet e pretenduara kundër z.
21 Shala, të nderuar.

22 Këta individë -- ka dëshmi lidhur me z. Shala që bien në
23 kundërshtim me pretendimet e dëshmive të tyre dhe pikërisht
24 këtë ne po ju paraqesim juve, të nderuar Gjykatës, pasi kjo
25 është mënyra më e mirë për ta bërë një gjë të tillë. Ne jemi

1 të lumtur në qoftë se ju thoni "Ata duhet të vijnë të japin
2 dëshmi", ne kemi qasje ndaj tyre, ka rregulla të tjera.

3 Megjithatë ne shohim se çfarë ka në deklaratat e tyre.
4 Dhe ne duam që ju t'i keni këto parasysh kur të arrini në
5 vendimin tuaj, të nderuar Gjykatës. Kjo rregullore e lejon një
6 gjë të tillë dhe ZPS-ja do të duhet të shpjegojë se përse nuk
7 e ka thirrur këtë, nëse cilat janë arsyet e tjera ose duhet të
8 thirren që të japin dëshmi këtu në sallën e gjyqit.

9 Kaq kisha, faleminderit e nderuar Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Unë shoh në shënimet e mia, që i është dhënë përgjigje
13 për të gjitha pikat e paraqitura. Megjithatë po kthej sytë nga
14 Prokuroria.

15 Z. Prokuror, keni marrë përgjigje për të gjitha pikat që
16 keni përmendur.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo?

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Desha
21 të thoja "janë prekur".

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, "janë prekur" pak a shumë.
23 Po përgjigje nuk është dhënë. Në qoftë se dëshironi që unë të
24 përgjigjem, unë do të jem i lumtur në qoftë se keni dëgjuar
25 mjaft, atëherë mjafton.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
2 të dëgjoj komentet të mëtejshme. Ajo që nuk dëgjova ishte
3 përgjigja ndaj pyetjeve që ne i kemi bërë. Prandaj do t'ju
4 kërkoja juve që jepni përpara.

5 Dhe pastaj z. Prokuror do t'jua jap fjalën juve për të
6 bërë parashtrime të mëtejme.

7 Avokati Aouini, është shumë e rëndësishme për mua që ta
8 diskutojmë në hollësi këtë çështje. Duam t'u japim juve
9 mundësinë e plotë për t'i paraqitur argumentet tuaja.
10 Megjithatë është shumë me vlerë që të kemi sqarime të duhura
11 për disa pika të caktuara.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Më lejoni t'i kthehem pyetjes suaj.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Pyetja ime ishte: Gjatë kohës së aktakuzës a kanë qenë këta
15 dëshmitarë në fabrikën e metalit në Kukës? Dhe a mund të
16 tregoni hollësi, jo informacione të përgjithshme, lidhur me
17 datën e saktë se kur kanë qenë atje.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne
20 kemi dëgjuar dëshmi që është diskutuar se ka patur mjaft vende
21 ku ka qëndruar UÇK-ja, por këtu po flitet në mënyrë të veçantë
22 për fabrikën e metalit në Kukës.

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Dhe
24 prandaj kemi thënë gjatë gjithë kohës që ju, të nderuar
25 Gjykatës, duhet të shkoni në vendin e krimit për ta parë të

1 saktë.

2 Ndërsa si përgjigje ndaj pyetjes suaj, e nderuar
3 Gjykatëse. Këta individë që janë anëtarësuar në UÇK dhe në
4 Brigadën 128 kanë qenë në Pikën 1 pasi Pika 1 ka qenë
5 operacionale. Dhe që nga ajo kohë, kemi edhe kohën kur ka
6 qëndruar. Kanë qëndruar në fabrikën e metalit në Kukës disa
7 herë. Disa që kanë qenë në Pikën 1 të brigadës janë shumë
8 afër. Ata mund të shpjegojnë sesi ushtarët nga brigada kanë
9 shkuar atje dhe pastaj në pika të ndryshme.

10 Një nga individët, siç thuhet, siç tregohet në
11 përmbledhjen e tij, numri 3 në listën tonë DW4-02 thotë që
12 shkoi njëherë atje për të marrë një garzë dhe shkoi tek Pika 2
13 ku thotë që aty bëhet fjalë për një fabrikë të metalit. Dhe
14 këto janë personat të cilët kanë hyrë disa herë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
16 unë nuk e kam fjalën për këto raste. E kam fjalën për
17 periudhën e kohës. Trupi Gjykues është i interesuar për afatin
18 kohor, për data të sakta nëse e keni këtë.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Në përgjithësi këta individë të
20 brigadës kanë qenë aty nga shkurti, përpara mobilizimit të
21 përgjithshëm, në kohë të ndryshme. Kanë qenë atje përpara
22 mobilizimit të përgjithshëm apo gjatë mobilizimit të
23 përgjithshëm. DW4-02 ka ardhë nga Gjermania gjatë kohës së
24 mobilizimit të përgjithshëm dhe ka shkuar në Kukës. Ky është
25 afati kohor.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
2 duket se nuk po bëj veten të qartë. Ne duam të dimë lidhur me
3 dëshmitarin 02, 03 dhe 11, nëse ju mund të na tregoni në
4 mënyrë më të posaçme sesi, se a keni afate të caktuara apo
5 kohë të caktuara, më specifike të posaçme, se kur kanë qenë
6 këta dëshmitarë gjatë kohës së aktakuzës në fabrikën e metalit
7 në Kukës, nëse pra, a mund të tregoni "A kanë qenë atje, për
8 shembull, rreth 20 majit?" apo "Në fund të majit?" apo "Në
9 datën 5 qershor?" apo "Kemi qenë në datën 10 qershor?" e
10 kështu me radhë, kjo është pyetja që po bëj unë.

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Premtojmë
12 që do t'i analizojë edhe një herë dhe do t'u japim saktësi
13 lidhur me datat, por aktualisht e vetmja gjë që kemi është
14 "mobilizimi i përgjithshëm" në fund të marsit dhe nga ajo
15 periudhë e më tutje ata mund të shpjegojnë nëse bëhet fjalë
16 për një javë, dhjetë ditë e kështu me radhë.

17 Dhe pika tjetër për të cilën kemi datë të caktuar është
18 incidenti i Burrelit. Dhe kështu mund të shikohet afati kohor
19 nga mobilizimi i përgjithshëm dhe me incidentin e brigadës 128
20 në Burrel. Dhe Operacioni "Shigjeta" në cilën kjo brigadë
21 është dislokuar në Kalimash në vijën e frontit. Këto janë
22 pikat kohore specifike.

23 Nëse keni nevojë për më shumë do t'ju japin edhe ato.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
25 Prokuror, e shoh që është ora 11.00. Sqarimi im ka bërë që të

1 arrijmë momentin e pushimit.

2 Do të vazhdojmë dhe pastaj do të vazhdojmë me seancën e
3 dytë.

4 Tani e pezullojmë seancën për gjysëm ore.

5 --- Pauza fillon në orën 11.02

6 -- Seanca rifillon në orën 11.31

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se erdhët, të vazhdojmë më tej.

9 Shoh që ZPS-ja ka të njëjtët të pranishëm si në seancën e
10 parë, e njëjta gjë është e vërtetë dhe për Mbrojtësin e
11 Viktimave. Ndërkohë që shikoj që disa kolegë nuk janë ende të
12 pranishëm nga Mbrojtja.

13 Z. AOUBINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Po, Kailin [E
14 pakuptueshme], gjithashtu edhe dy kolegë të tjerë znj. Kolbe,
15 dhe Juliette janë larguar nga salla e gjyqit. Për procesverbal
16 kjo.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
18 lamë aty ku ju na dhatë disa sqarime të tjera lidhur me
19 pyetjen që bëmë ne lidhur me dëshmitarët 2, 3 dhe 4 [Sipas
20 përkthimit], 11 po ashtu.

21 Tani, domethënë, dua t'ia jap fjalën Prokurorit për disa
22 pyetje të tjera.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
24 Gjykatëse. Disa prej dëshmitarëve janë diskutuar nga Avokati i
25 Mbrojtjes gjatë parashtrimeve të tyre kështu që nuk do të

1 bëjmë pyetje lidhur me rëndësinë e tyre. Megjithatë, duam që
2 të ngremë dy apo tre pika të tjera.

3 Së pari, lidhur me dëshmitarët ndërkombëtarë, me dëshmitë
4 e ndërkombëtarëve. Mbrojtja beson që nëse ndonjë nga dëshmitë
5 e tyre bie ndesh me dëshmitarët konkretë në këtë çështje, ose
6 me pjesë të dëshmisë së tyre, ne kërkojmë që Trupi Gjykses të
7 kërkojë që të thotë Mbrojtja se cilat janë këto pjesë të
8 deklaratave të cilat bien ndesh me dëshmitë e thëna nga
9 dëshmitë e Prokurorisë edhe si e mbështet kjo provat e
10 Mbrojtjes. Ne parashtrojmë, të nderuar Gjykatës, që Mbrojtja
11 nuk ka parashtuar mbështetshmëri të përshtatshme dhe të
12 mjaftueshme në parashtrimet e veta.

13 Deklarata të tilla si prova për situatën e përgjithshme
14 do të na ndihmojnë të kuptojmë se çfarë është e vërtetë dhe
15 çfarë nuk është e vërtetë, sikurse dhe këtu citoj atë çfarë
16 tha Avokati në faqen 42 të transkriptit. Nuk na ndihmojnë, nuk
17 na vlejné kaq shumë.

18 Sigurisht që ata janë të mirëpritur që të bëjnë
19 parashtrime të tjera të cilat mund të japin hollësi të
20 mëtejshme, dhe besoj që këto parashtrime janë të rëndësishme
21 për ju, të nderuar Gjykatës, në mënyrë të tillë që të arrini
22 në një vendim për këtë gjykim. Megjithatë, ne mendojmë që
23 informacioni që kemi nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar
24 që dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë të rëndësishme.

25 Sa i takon regjistrimit, regjistrimit të varrimit, në

1 këtë pikë nuk e kuptojmë se çfarë rëndësie ka regjistrimi, një
2 gjë e cila ka ndodhur jashtë. Deri tani nuk është se kemi
3 dëgjuar asgjë tjetër më të hollësishme sa i takon asaj çfarë
4 është parashtruar nga Mbrojtja në përmbledhjet e tyre.

5 Ndërkohë, dëshirojmë që të -- u tha nga Avokati që ata
6 dëshirojnë që të nxjerrin shumë prova lidhur me Brigadën 128.
7 Në faqen 40 Mbrojtja thotë se dëshirojnë që të nxjerrin më
8 shumë informacion që ka të bëjë me lëvizjen e Brigadës 128.

9 Së pari, ky është një deklaratë shumë e përgjithshme, siç
10 është thënë edhe në faqen 39, i akuzuari nuk pretendohet se
11 nuk ka qenë anëtar i kësaj brigade, kështu që në momentin që i
12 akuzuari nuk ka qenë anëtar i kësaj brigade, atëherë si ka
13 rëndësi informacioni që ka të bëjë me mënyrën se si ka
14 funksionuar Brigada 128?

15 Për shembull, lëvizja e brigadës në Nashec, apo elementë
16 të tjerë të brigadës, pra duhet që të shtjellohen më tej edhe
17 Mbrojtja duhet të na thotë se çfarë teorie kanë ato për këtë
18 provë. Kështu që, besoj që kemi të drejtë të kërkojmë disa
19 shpjegime të tjera më të hollësishme nga mbrojtja për ta
20 kuptuar më mirë pozicionin e tyre, dhe vlerën e një dëshmie të
21 tillë.

22 Ne parashtrojmë, të nderuar Gjykatës, që shpjegimet e
23 dhëna nga Mbrojtja nuk hedhin më tepër dritë se sa ne kishim
24 më përpara dhe si rezultat e kundërshtojmë rëndësinë e këtyre
25 dëshmimeve përpara Trupit Gjykses.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Mbrojtësi i Viktimave, e keni fjalën ju.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Avokat, fjala për juve.

6 Z. AOUMINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

7 Kryegjykatëse. E kuptojmë që ZPS-ja dëshiron që neve të bëjmë
8 parashtrimet përmbyllëse ose të na e vërë ne barrën e provës.

9 Por ne nuk do biem në atë kurth.

10 Megjithatë, dëshirojmë që të themi dhe një herë që në
11 dokumentin e vet në paragrafin 9, ZPS-ja pretendon që z. Shala
12 ka qenë pjesë e Brigadës 128. Ne do të sjellim anëtarë të
13 ndryshëm që kanë mbajtur role të ndryshme në Brigadën 128, që
14 do të thonë që Pjetër Shalën nuk e njohin, nuk ka qenë anëtar
15 i Brigadës 129 [Sipas përkthimit] dhe gjëra të tjera të
16 lidhura po ashtu me Brigadën 128. A është e rëndësishme kjo?
17 Sipas parashtrimit tonë, sipas qëndrimit tonë, kjo është shumë
18 e rëndësishme për çështjen.

19 Ne e shpjeguar lëvizjen e brigadës, z. Shala nuk ka qenë
20 pjesë e kësaj brigade dhe duam të theksojmë dhe një herë, dhe
21 ne sjellim prova nga njerëz që kanë qenë të pozicionuar në
22 fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës dhe që kanë punuar
23 aty me pjesën logjistike dhe që do të thonë që nuk e kanë parë
24 z. Shala aty, ose që e kanë parë ndoshta vetëm një ditë të
25 vetme z. Shala, kur ka marrë armët dhe ka shkuar për të

1 luftuar për çlirimin.

2 Pretendimet e ZPS-së që nuk janë mbështetur dhe që nuk
3 janë provuar nga ZPS-ja ne po jua sjellim në vëmendjen tuaj,
4 të nderuar Gjykatës. Për shembull, në rastin e W4-02, ky
5 dëshmitar shpjegon klinikën, pra do sjellim gjithashtu dhe një
6 dëshmitar tjetër që është dëshmitari DW4-05. Është personi i
7 cili ka qenë në magazinë ku pretendohet që kanë qenë të
8 ndaluar persona dhe janë mbajtur aty. Ai do shpjegojë se çfarë
9 ka ndodhur në këtë pikë. Pra këta janë persona që kanë pasur
10 role të caktuara dhe që do të vijin të na shpjegojnë se çfarë
11 ka ndodhur.

12 Sa i takon ndërkombëtarëve, ne u kemi dhënë shumë
13 hapësirë ZPS-së që të paraqesë [REDAKTUAR],
14 [REDAKTUAR]. Dhe
15 individë të cilët neve nuk i kemi kontaktuar dot kanë
16 deklarata. Kështu që në këtë fazë, të nderuar Gjykatës, ne do
17 t'i parashtrojmë këto emra për t'ju dhënë ju kontekstin,
18 domethënë këta janë persona të cilët kanë shkruar raportet,
19 kanë marrë pjesë në këto ngjarje, kështu që ne do t'i bëjmë
20 ata për elementë të cilët janë parashtruar gjatë
21 kundërpyetjeve të dëshmitarëve të Prokurorisë. Domethënë, do
22 t'i pyesim për gjëra të tilla, për shembull: Ku janë ushqyer,
23 ku kanë ngrënë këta persona? Në katin e parë, apo në katin e
24 tretë? Apo ku u gjet trupi i vdekur. Dhe pyetje të tjera të
25 cilat besojmë, të nderuar Gjykatës, që do t'ju ndihmojnë juve

1 shumë në mënyrë të tillë që të arrini një përfundim për
2 besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve. Në veçanti, të një
3 dëshmitari.

4 Dhe, situata në atë kohë është e rëndësishme për të
5 vlerësuar në qoftë se dikush mund të shtojë elementë të
6 tepërt, elementë të mëtejshëm në historinë e tyre. Dhe këta
7 janë persona të cilët do të pyeten prej nesh për shembull sesa
8 të ndaluar ka pasur, ka pasur një, ka pasur 10, ka pasur 12? E
9 kuptojmë që kjo nuk është ajo çfarë ka ndodhur konkretisht në
10 Kukës, por në fund të fundit kjo është ajo çfarë na është vënë
11 përpara nga Prokuroria. Kështu që ne do të shtjellojmë pistën
12 e besueshmërisë së dëshmitarëve.

13 Dhe ne besojmë që kjo është mbështetje për pistat tona
14 dhe do t'ju japim edhe në materiale, domethënë në formë të
15 shkruar, pra [REDAKTUAR]
16 [REDAKTUAR]. Një ndër individët ka bërë
17 udhëtimin, ka transportuar disa persona të liruar, njëri prej
18 tyre nuk ka qenë aty fare ndërkohë që personi i tretë që nuk
19 ka qenë aty ka nënshkruar deklaratën dhe mund t'ju shpjegojë
20 sesi është përpiluar dokumenti. Pra këta janë elementë që do
21 t'ju bëjnë ju të mundur që të vlerësoni besueshmërinë të
22 paktën e një dëshmitari, të një individi, në ngjarjet
23 konkrete. Dhe do t'ju luteshim ju, të nderuar Gjykatës, që të
24 kuptoni që kjo qëndron në thelb të çështjes.

25 Në qoftë se doni që të shtjellojmë ndonjë çështje tjetër,

1 ju lutem më thoni, por sa i takon këtij elementi pra sa i
2 takon individëve dhe brigadës, besoj se dhamë shpjegime të
3 mjaftueshme lidhur me këtë. Z. Gilissen do të ketë ca
4 parashtrime të përgjithshme sa i takon kontekstit që do të
5 parashtrojmë përpara jush, të nderuar Gjykatës, sepse ZPS-ja
6 bëri disa zgjedhje të saj për parashtrimin e çështjes së vet,
7 ndërkohë që ne duam që t'ju japim informacion për të parë të
8 gjithë panoramën, të nderuar Gjykatës.

9 Dhe kjo është detyra jonë për të mbrojtur z. Shala që nuk
10 ka qenë pjesë e pretendimeve që ka ngritur ZPS-ja kundër tij.
11 Faleminderit për vëmendjen.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, Avokat.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mundem unë të flas?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
16 po. Patjetër.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë shkurt.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
19 merrni kohën që nevojitet, por përpara se t'ju jap fjalën
20 dëshiroj të bëj një konstatim tjetër.

21 Dëshmitarët -- dhe për qartësim po ndjek numrat në listën
22 e dëshmitarëve, domethënë janë dëshmitarët 2, 3, 7, 9, dhe 13,
23 të gjithë ata diskutojnë për Brigadën 128. E dimë këtë gjë.
24 Thjesht dëshiroj të theksoj që ne vlerësojmë edhe elementin e
25 përsëritjes. Pra, shohim në qoftë se ka përsëritje kur

1 vlerësojmë përfundimisht se cilët janë dëshmitarët që do të
2 japin dëshmi, dhe thjesht do t'jua sillja këtë në vëmendjen
3 tuaj.

4 Z. AOUINI: [Përkthim] Përpara sesa të marr fjalën z.
5 Gilissen.

6 Dëshiroj të them që dy dëshmitarët i kemi kontaktuar,
7 kemi vërtetuar që ata do të jenë pjesë e bllokut të dytë dhe
8 bëhet fjalë për dëshmitarët që janë me numër 3 dhe numër 11 në
9 listën e dëshmitarëve.

10 Ju shpjeguar pak më herët sa i takon dëshmitarit 7, ai ka
11 probleme shëndetësore dhe na duhet të takohemi me të për të
12 parë në qoftë se është i përshtatshëm për të dhënë dëshmi. Do
13 japim hollësi të tjera për të thënë në qoftë se ai është i
14 përshtatshëm dhe në gjendje të japë dëshmi përmes
15 videolidhjes.

16 Sa i takon numrit dy në listë, të nderuar Gjykatës, dhe
17 numrit 9 --

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] 2, 3,
19 7, dhe 9 -- jo, doja të thoja 11. Bëra një gabim, thashë 9,
20 por e kisha fjalën për 11, në fakt doja të thoja 11.

21 Z. AOUINI: [Përkthim] Për 11 siç e thashë -- do merret
22 përsëri në pyetje sa i takon numrit tjetër, për numrin 2 ky
23 është një person i brigadës i cili nuk e njeh z. Shala. Dhe ne
24 këtë individ nuk mundëm ta takonim, refuzoi që të takohet me
25 ne, dhe për këtë arsye ne teknikisht kemi dy individë, dy

1 persona të cilët kanë mundësi që të vijnë dhe kanë elementë të
2 ndryshëm nga njëri-tjetri që mund të sjellim përpara Trupit
3 Gjykues. Njëri ka pak më shumë informacion, më shumë për sa i
4 takon incidentit në Burrel dhe klinikës dhe magazinës, pra ku
5 ndodhej magazina. Dhe kemi dëgjuar dëshmitarët që flasin për
6 këtë person me emër që qëndronte në magazinë. Në qoftë se nuk
7 e kam gabim, bëhet fjalë për dëshmitarin DW4-10. Ne pra e
8 marrim dëshminë nga personi që përmendet atje. Dhe, ne
9 parashtrojmë që kjo është shumë konkrete, është një
10 informacion shtesë. Kemi informacion konkret gjatë periudhës
11 së aktakuzës kur flitet ose për klinikën ose për magazinën,
12 dhe dëshirojmë që të japim më shumë informacion lidhur me këto
13 vendngjarje.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull, z. Gilissen, fjala për ju.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar
17 Kryegjykatëse.

18 Për të folur shkurt, më duhet të them që jam pak i
19 zhgënjyer sepse kam ndjesinë që ka një lloj nxitimi për
20 përfundimin e çështjes ose për të mos i dhënë mundësi
21 Mbrojtjes të prezantojë provat e veta nga kolegët e ZPS-së.

22 Provat janë mbledhur dhe ti bën përzgjedhje të caktuara
23 që, për shembull, të mos flasësh për gjëra të caktuara. Dhe
24 ajo çfarë jep ti është një imazh i besueshëm ose një imazh që
25 mund të ketë ndodhur, të realitetit, sepse vendos që të mos

1 tregosh apo t'ju paraqesësh gjykatësve disa pjesë të
2 realitetit. Pjesë të cilat janë shumë të rëndësishme të cilat
3 po të prezantoheshin, do të ndryshonin të gjithë panoramën. Ne
4 pikërisht këtë duam të bëjmë në mënyrë të tillë që t'ju bëjmë
5 ju të mundur që të keni një panoramë të plotë të gjërave që
6 kanë ndodhur dhe të realitetit të gjërave.

7 E vërteta, të gjithë ne kemi ide tona për të vërtetën,
8 por ne po flasim këtu për realitetin dhe ka shumë mungesa.
9 Është e befasueshme që të thuash që ka probleme me datat. Neve
10 jemi të detyruar që të dëgjojmë edhe gjëra të cilat çfarë kanë
11 ndodhur në 1998, gjatë disa orëve, që jashtë -- periudhë e
12 cila shkon përtej kohës së aktakuzës.

13 Dhe ka pasur persona që kanë qenë në Kukës, persona të
14 cilët janë në gjendje që t'ju japin ju informacion për mënyrën
15 e jetesës në Kukës, për organizimin atje, kush ishte atje,
16 kush ishte përgjegjës për atë çfarë ndodhën apo jo.

17 Madje jo vetëm kaq, por kemi edhe dikë, një burrë që na
18 ka dhënë sekuenca videoregjistrime të asaj çfarë ka ndodhur në
19 fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës. Do të kemi mundësi
20 që të shikojmë persona që kanë qenë atje, dhe do të na
21 dëshmojnë për ngjarjet shumë të rëndësishme dhe në qoftë se do
22 të na duhet që të besojmë dëshmitarët e Prokurorisë, do shohim
23 që edhe kokat, edhe drejtuesit, dhe këta peshqit e mëdhenj të
24 UÇK-së kanë qenë në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës
25 për të përmbushur rolet e tyre gjatë këtyre tre ditëve.

1 Dhe ne këtë film, apo këtë video e kemi. Dhe për këtë
2 arsye kemi shpenzuar shumë kohë në mënyrë të tillë që të
3 mbledhim dëshmitarë, apo që të identifikojmë se kush e ka
4 drejtuar operacionin apo jo. Apo kush ka pasur mundësi për
5 shembull pas një fjalimi që ka qenë, ka pasë mundësi pastaj që
6 të drejtojë një operacion. Ndërkohë që sa i takon dëshmitarëve
7 -- në qoftë se besojmë dëshmitarët e ZPS-së, askush nuk është
8 pjesë e kësaj panorame. Askush.

9 Ne jemi në pikë shumë të rëndësishme të kësaj çështjeje.
10 Në qoftë se na besoni, ose në qoftë se na -- keni domethënë
11 vlerësim për punën tonë, kjo nuk është e rëndësishme. Ne nuk
12 jemi fëmijë, ne i kemi të gjithë elementët që janë të
13 nevojshme në dorë. Jam i sigurt që kur të keni të gjithë
14 panoramën e plotë, kur të keni të gjithë elementët për të
15 vendosur, jam i sigurt që do vendosni në mënyrë të drejtë. Dhe
16 unë hamendësoj, besoj, që ju do të konsideroni të gjithë
17 elementët dhe ZPS-ja në vetvete nuk është se i ka paraqitur të
18 gjithë elementët. Pra kjo është ajo çfarë mendojmë ne.

19 Kështu që do ju lutesha që të kemi mundësi që të bëjmë ca
20 pyetje për këta dëshmitarë. Ne themi, e parashtrojmë këtu, dhe
21 nuk është sekret në fakt që ne kemi folur me shumë persona dhe
22 disa njerëz, nuk e kam fjalën për dy apo tre persona, por
23 shumë njerëz kanë kontaktuar me ne sepse dëshironin që të
24 ishin dëshmitarë dhe ne i kemi refuzuar ata që të vinin këtu
25 si dëshmitarë sepse ne e urrejmë mënyrën sesi janë përdorur

1 dhe e kuptojmë plotësisht që këta elementë mund të binin disa
2 elementë në këtë çështje të cilat nuk janë të rëndësishme, nuk
3 janë me vend për çështjen në fjalë.

4 Pra, ne kemi bërë ca përzgjedhje shumë, shumë delikate
5 dhe të komplikuar, të ndërlikuar, dhe unë jam i sigurt që ju
6 do të realizoni një gjykim vërtet të drejtë dhe do të lejoni
7 sjelljen e dëshmitarëve të propozuar prej nesh të japin dëshmi
8 në sallën e gjyqit. Sigurisht, ne do t'ju japim të njëjtin
9 informacion që do të jetë i nevojshëm dhe në qoftë se e
10 vlerësojmë që duhet të tërhiqet një dëshmitar do ta bëjmë këtë
11 gjë, ju jap fjalën për këtë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, Avokat. Besoj që komenti juaj që jeni pak i
14 zhgënjyer sa i takon, le të themi, boshatisjes së çështjes
15 suaj, nuk e keni në lidhje me ne apo jo?

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Sigurisht, sigurisht. Nuk e kam
17 për ju, e kam për kolegët e ZPS-së. Nuk jam i mësuar me këtë
18 pozicion. Ju kërkoj ndjesë që s'u ngrita në këmbë.

19 Deri tani, mendoj që ne kemi marrëdhënie të shkëlqyera
20 sepse synimi është që të zbulohet e vërteta. Por, tani unë
21 pyes veten çfarë po ndodh, pse? Ata kanë frikë nga çfarë? Kanë
22 frikë që të dëgjojnë disa njerëz? Ne e dimë që ata janë
23 persona që kanë qenë pjesë e brigadës, kanë qenë persona në
24 listën e UÇK-së. Çfarë? ZPS-ja ka frikë t'i dëgjojë këta
25 njerëz? Nga çfarë ka frikë? Ka frikë nga realiteti? Kjo është

1 pyetja. Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
3 kemi përfunduar diskutimin për përmbajtjen e dëshmitarëve deri
4 tani? Z. Prokuror, keni gjë tjetër për të shtuar?

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Nuk
6 kemi parashtrime të tjera për këtë pikë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Mbrojtësi i Viktimave?

9 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull atëherë.

12 Vazhdojmë me pikën tjetër në rendin e ditës. Le të
13 kalojmë në seancë private për një çast, për dy minuta, pastaj
14 do të kthehemi përsëri në seancë publike.

15 Znj. Sekretare, ju lutem, a mund të kalojmë në seancë
16 private?

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 jemi në seancë publike.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Kalojmë në pikën tjetër në rendin e ditës, që ka të bëjë
12 me dëshmitarët ekspertë. Më konkretisht, dëshmitarin 4 në
13 listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe dëshmitarin 3 në të
14 njëjtën listë.

15 Marrim parasysh parashtrimet e ZPS-së sa i takon
16 kualifikimeve dhe eksperiencës së punës së dëshmitarit 03, që
17 jepet në parashtrimin e protokolluar 617 në paragrafët 3 dhe
18 4.

19 Avokati i Mbrojtjes, a dëshironi që t'i përgjigjeni
20 parashtrimeve të bëra nga ZPS-ja? Dhe a jeni në gjendje që të
21 jepni një biografi më të hollësishme të dëshmitarit, dhe në
22 qoftë se po, deri në çfarë kohe mund të na jepni një biografi
23 më të hollësishme të tij?

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam shumë
25 për të thënë përveç faktit se ne i qëndrojmë qëndrimin që

1 personi apo dëshmitari ekspert ka kualifikimet e nevojshme për
2 të dhënë dëshminë e tij para Trupit Gjykues. Në qoftë se
3 dëshironi që të bëjmë parashtrime më të hollësishme, mund
4 t'jua bëjmë këtë me shkrim. Në qoftë se doni që të japim më
5 shumë hollësi për përvojën profesionale të personit për
6 biografinë e tij, mund ta bëjmë këtë gjë.

7 Megjithatë, ne -- besojmë që kemi kontaktuar me ekspertët
8 më të kualifikuar në të gjithë Evropën për çështje balistike
9 dhe çështje të lidhura me to. Ne parashtrojmë që bëhet fjalë
10 për një ekspert me shumë kualifikime. Është një ekspert
11 britanik i cili ka vite apo dekada, që punon për çështje të
12 ndërlikuara të cilat kanë të bëjnë me armët, me çështje
13 balistike dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me armë e armatime.
14 Nëse, të nderuar Gjykatës, ju kërkoni që ne të bëjmë një
15 parashtrim me shkrim, pa diskutim mund ta bëjmë këtë gjë, edhe
16 në qoftë se doni që të marrim një biografi më të hollësishme
17 personale, për përvojën personale të personit, mund t'ia
18 kërkojmë ekspertit dhe mund t'jua japim.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit. Po, për kohën kur mund të jeni në gjendje të
21 jepni një CV ose biografi më të hollësishme të personit në
22 fjalë?

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju premtojmë që mund t'ia kërkojmë
24 sot, fatkeqësisht jemi ende në gusht. Dhe, kur kemi kontaktuar
25 me ta përmes institutit ku ata punojnë, përgjigjet, që nga

1 pushimi i gjykatës -- nuk ka qenë shumë i shpejtë për shkak të
2 pushimeve të verës, për shkak të faktit që jemi në gusht. Dhe
3 për këtë arsye, ne kemi planifikuar aktualisht që ky dëshmitar
4 të japë dëshmi në bllokun e fundit të dëshmitarëve për të mos
5 pasur surpriza. Megjithatë, në përgjigje të pyetjes suaj mund
6 t'ia dërgojmë këtë pyetje dëshmitarit sot dhe mund t'ju
7 informojmë në momentin e parë që të kemi një përgjigje prej
8 tij.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Sa i takon planifikimit të dëshmitarit, gjithashtu mund
12 të përpiqemi që të mos e lëmë për bllokun fare të fundit të
13 dëshmitarëve, në varësi të mënyrës se si do të shkojnë gjërat.
14 Se nuk është se gjërat janë shumë fikse, nuk janë të shkruara
15 në gur.

16 Z. Prokuror, keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këtë
17 çështje?

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për këtë pikë nuk kemi gjë për
19 të shtuar.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Mbrojtësi i Viktimave, keni gjë për të shtuar?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam gjë për të shtuar.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit. Në rregull, i kemi mbajtur shënim parashtrimet
25 tuaja dhe do t'i cekim edhe nesër ato.

1 Ndërkohë, tema tjetër në rendin e ditës, pika tjetër në
2 rendin e ditës, ka të bëjë me kërkesa sipas rregullës 153,
3 154, dhe 155 të Rregullores. Kemi vënë re disa ndryshime në
4 këtë aspekt.

5 Avokati i Mbrojtjes, a keni gjë për të shtuar sa i takon
6 parashtrimeve të shkruara tuaja?

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, jo të nderuar Gjykatës, por
8 vlerësimi i rregullave ose të mënyrës se si duhet të
9 procedohet me të, është së pari të merret parasysh rregulla
10 123 [Sipas përkthimit], megjithatë, ne nga ana e Mbrojtjes
11 jemi të ndërgjegjshëm për ndërveprimin ose ndërthurjen e
12 rregullave të ndryshme. Megjithatë mund t'ju them që jemi të
13 lumtur që në qoftë se këta individë do të thërriten, kjo është
14 një çështje që duhet të vendoset nga Gjykatësi.

15 Sepse ne nuk kemi kontakt me ta, se jemi ose nuk kemi
16 kontakt fare -- kanë refuzuar që të kenë kontakt me ne. Dhe
17 për këtë arsye, na duhet që t'ju kërkojmë ju të nderuar
18 Gjykatës, që të lëshonim fletëthirrje në mënyrë të tillë që
19 ata të detyrohen që të vijnë. Pra, pjesa më e madhe e tyre nuk
20 është se kërkojnë shumë kohë në sallën e gjyqit, në qoftë se
21 vendosni që të thirren në sallën e gjyqit. Megjithatë, ne
22 mendojmë që pika nistore, pika fillestare duhet të jetë
23 rregulla 151 [sipas përkthimit].

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Atëherë, z. Prokuror ose znj. Prokurore, dëshironi që të thoni

1 ndonjë gjë në lidhje me këtë pikë?

2 Znj. PERGOLO: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Kolegu
3 im bëri disa komente që ka të bëjë me disa -- me rëndësinë
4 prej disa prej dëshmitarëve të propozuar, dhe këtu përfshihen
5 dëshmitarët që bien nën rregullën 153, për shembull 883 [Sipas
6 përkthimit] e të tjerë.

7 Megjithatë, sa i takon dëshmitarëve të tjerë të cilët do
8 të thërriten sipas rregullit 153, ne do kërkonim që dëshmia e
9 tyre të jepet sipas këtij rregulli. Megjithatë do të
10 përgjigjemi në momentin kur të parashtrohet parashtrimi, kur
11 të dorëzohet parashtrimi i Mbrojtjes.

12 Sa i takon 155, sikurse e thamë edhe përpara, nuk është e
13 qartë për ne se çfarë rëndësie kanë dëshmitarët. Megjithatë
14 duam që të qartësohemi, të sqarohemi më tej për sa i takon
15 kërkesave që bien nën rregullin 155, dhe të japim përgjigjet e
16 nevojshme kur të kemi më shumë informacion.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Mbrojtësi i Viktimave, keni për të shtuar diçka?

19 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi gjë për të shtuar.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka
21 nevojë që të bëjmë edhe një xhiro të dytë të palëve,
22 faleminderit.

23 Pika që përmendët z. Avokat Mbrojtës lidhur me
24 fletëthirrjet është pika e radhës në rendin e ditës, thirrjet
25 e dëshmitarëve në bazë të rregullës 121(3) i Rregullës.

1 Kuptojmë z. Avokat që janë 8 dëshmitarë në listën tuaj që kanë
2 refuzuar të takohen me ju, nuk kanë pranuar. Apo me të cilët
3 s'keni pasë kontakte të tjera.

4 Dhe, për nevojat e procesverbalit dëshmitari 441 [sipas
5 përkthimit], 4280, 4440, 2517, dëshmitari 3881, dëshmitar
6 2549, dëshmitari 4405, dhe dëshmitari 4454.

7 Konstatuam se synoni të bëni një -- parashtroni një
8 kërkesë sipas rregullës 121(3) për dëshmitarin 2517 dhe për
9 dëshmitarin 2549, ndërsa për të tjerët keni qëllim që të bëni
10 kërkesë sipas rregullës 153.

11 Dhe me sa kuptoj, z. Avokat, në qoftë se këto miratohen,
12 dhe bëni kërkesë sipas rregullës 153, e cila refuzohet,
13 atëherë do të kërkoni që këta dëshmitarë të thirren nga Trupi
14 Gjykues. A është saktë, e kam kuptuar mirë për arsyen që të
15 jemi të qartë?

16 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, znj. Gjykatëse. Është pak më e
17 detajuar se kaq. Edhe po të pranohet nga ju, ju po kërkoni që
18 ata të merren në pyetje nga pala tjetër. Do të shkojmë atëherë
19 te rregulla 154(3), besoj që ne kemi -- do të kërkohet që ju
20 t'i thërrisni ata nga ana juaj, Trupi Gjykues.

21 Ne nuk kemi mundësi që t'i thërrasim këta individë, të
22 tjerët pra, nuk kemi kontakt me ta. Në qoftë se ata kërkojnë
23 se një pjesë të vijnë, mund ta bëjnë përmes videolinkut, një
24 pjesë të dëshmisë së tyre.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Rregulla 121(3) e Rregullave, parasheh që i përket
2 Mbrojtjes që të thërrasë dëshmitarët e saj, natyrisht dhe
3 është përgjegjësi e juaja kjo. Trupi Gjykues dëshiron të dijë
4 çfarë përpjekjesh keni bërë që të kontaktoni këta dëshmitarë.
5 Kjo është pyetja e parë, pjesa e parë e pyetjes. Ndërsa pika e
6 dytë që nuk është tamam pyetje, më shumë një konstatim, një
7 prej kriterëve është që në qoftë se ne vendosim t'i thërrasim
8 këta dëshmitarë, është përgjegjësi e juaja që të na siguron
9 neve informacionet e nevojshme identifikuese të këtyre
10 dëshmitarëve, vendbanimi i tyre. Doja ta bëja këtë të qartë
11 sepse ne nuk mund të vrapojmë në kërkim të dëshmitarëve. Dhe
12 siç e thatë dhe ju, nuk janë të gjithë këta në Kosovë. Në bazë
13 të deklaratave kemi konstatuar që një pjesë e tyre nuk janë në
14 Kosovë, nuk banojnë aty.

15 Pra, në qoftë se mund të na jepni ca sqarime shtesë
16 lidhur me përpjekjet që keni bërë, dhe në qoftë se është e
17 mundur do të doja që të na jepnit hollësi.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.
19 Besojmë se është më pak e ndërlikuar se sa t'i kërkosh në
20 gjithë botën, ata kanë qenë në kontakt me ZPS-në, pra ndoshta
21 mund ta dimë se ku t'i gjejmë ato të dhëna personale të tyre.

22 Megjithatë, do t'i marr individët dhe t'ju sqaroj që kemi
23 ndërmarrë.

24 Fillojmë me dëshmitarin W04454, më duket se është numër
25 2, i dyti në listë. Kemi kërkuar kontaktet e tij nga ZPS-ja.

1 ZPS-ja na ka ndihmuar, ka pyetur atë nëse pranojnë që të
2 kontaktohen nga Mbrojtja, të cilët individ i në fjalë e ka
3 refuzuar këtë kontakt.

4 E njëjta gjë vlen edhe për W04405. E njëjta gjë për
5 04454.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
7 ngadalë ju lutem. Pra, është refuzuar, nuk kanë pranuar që të
8 hyjnë në kontakt, por me sa duket kemi adresën. Sepse ajo që
9 më intereson -- janë të dyja në fakt. Përpyekjet tuaja për të
10 hyrë në kontakt me ta, por edhe informacionet për sa u përket
11 vendbanimit të tyre që të dimë se sa e ndërlikuar është
12 situata.

13 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, znj. Gjyqtare. Po e marr një
14 nga një dhe ju sqaroj situatën për secilin.

15 Pra, dy në listë që i përmenda, W04454, ZPS-ja i ka
16 takuar këta dëshmitarë, fillimisht, sepse i kishin të dhënat e
17 tyre. Ky individ refuzoi që të dhënat e tij të na
18 komunikoheshin neve, pra Mbrojtjes. Jemi përpyekur që t'i
19 gjejmë dhe t'i kontaktojmë në forma të tjera, por pa sukses.
20 Nuk kemi patur asnjë kontakt me këtë individ, e vetme gjë që
21 kemi është deklarata e tij dhe informacioni që ZPS-ja i ka
22 kontaktuar. Pra, në qoftë se arrijmë te momenti i
23 fletëthirrjes, do na duhet ndoshta që t'i kërkojmë ZPS-së që
24 të na japë të dhënat personale, që mund të na ndihmojnë për të
25 parashtruar kërkesën te ju znj. Gjykatëse. Ky ishte për të

1 parin.

2 Kalojmë te W04405. Është i pesti në listën tonë. E
3 njëjta situatë, nuk ka pranuar që kontaktet e tija të na
4 komunikohen neve, Mbrojtjes, që i kemi kërkuar përmes ZPS-së.
5 Megjithatë, një fije shpresë kemi këtu, kemi arritur që të
6 vendosim një kontakt të tërthortë përmes një personi që ai
7 njeh dhe shpresojmë, presim që të marrim një përgjigje. E
8 njëjta gjë si me ZPS-në. Të shohim nëse ky person pranon të
9 takohet me neve apo jo, për momentin s'kemi marrë asnjë
10 përgjigje.

11 Ka qenë pak e vështirë sepse janë dy persona me të
12 njëjtin emër që ishin në UÇK në kohën e luftës. Njëri ka qenë
13 komandant i lartë, ndërsa tjetri ushtar, që është personi që
14 na duhet. Por akoma s'kemi marrë përgjigje, në qoftë se marrim
15 -- vendosim një kontakt, në qoftë se arrijmë që të vendosim
16 një kontakt, atëherë ndoshta do të përpiqemi ta sjellim vetë
17 këtu përmes përpjekjeve tona. Por nuk kemi informacione të
18 përditësuara në këtë fazë.

19 Kalojmë tek -- W04441 dhe W04440 së bashku.

20 440, e kemi takuar një herë, jam i vetëdijsëm që jemi në
21 seancë publike. Jemi takuar një herë me të pra, për të kuptuar
22 që ky person nuk mund të bashkëpunojë me ne. Kemi përmendur
23 probleme shëndetësore dhe mungesën e dëshirës. Arsyet e
24 thirrjes së tij është në deklaratë, s'ka qenë kurrë në Kukës.
25 S'ka pasë asnjë rol në Kukës.

1 Por, kemi një refuzim të qartë për të dhënë dëshmi. Kjo
2 është një nga arsyet për të cilat duam deklaratën e tij. Për
3 këtë pikë të vogël që mund ta vërtetojmë përmes deklaratës,
4 është një pikë shumë e shkurtër.

5 E njëjta gjë vlen për individin tjetër që është W0441.
6 Kemi vetëm kontakte jo të drejtpërdrejta me të, është një
7 kontekst i ngjashëm, fakte të ngjashme, pra kemi kontakt
8 përmes dëshmitarit të parë, pra 4440. Dhe kjo na ka dhënë pak
9 shpresë që ndoshta mund të takohemi me këtë individ, por pas
10 disa përpjekjesh dhe disa justifikime nga ana e tij, na ka
11 bërë të qartë që nuk dëshiron të takohet me ne. Pra nuk jemi
12 takuar me të dhe për arsye të ngjashme, edhe këtu kërkojmë
13 deklaratën e tyre. Ose që të thirren të japin dëshmi në
14 gjykatë për të dhënë dëshmi lidhur me këtë pikë në veçanti.
15 Asgjë më tepër.

16 Kthehemi tek një individ tjetër, znj. Gjykatëse, nëse më
17 lejoni?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
19 po, vazhdoni.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Pra, W044280 [Sipas përkthimit], që
21 i bie të jetë i nënti në listën tonë, e kemi kërkuar nga ZPS-
22 ja, kërkesa është refuzuar, kërkesa pra që kontaktet e tija të
23 na jepeshin neve. Dhe me gjithë përpjekjet tona, nuk kemi
24 arritur të gjejmë se ku banon ky person. Besojmë që jeton në
25 Kosovë, por s'kemi detaje të tjera. Megjithatë, besojmë që

1 ZPS-ja është në një pozicion më të mirë për të gjetur të
2 dhënat zyrtare se ku mund t'i drejtojmë ne letër ne, apo
3 përpjekjet tona për të hyrë në kontakt e komunikuar me të.

4 Sa i përket tre ndërkombëtarëve së bashku. Jemi përpjekur
5 të kontaktojmë të paktën njërin prej tyre, përmes të dhënave
6 të tij private që nuk ndërlidhen me funksionet e tija zyrtare.
7 Të dhëna private që i kemi gjetur, kjo gjë është bërë në
8 nëntor 2022, dhe akoma s'kemi marrë ndonjë përgjigje. Kemi
9 kërkuar të dhënat e tij nga ZPS-ja, na është thënë qartë që
10 neve na ndalohet të hynim në kontakt me të, për shkak të
11 natyrës së punës së tyre, rrethanat, dhe besoj që pajtohemi të
12 dy palët me këtë pikë.

13 Tani do kaloj tek rregulli 155, individi që varet nga
14 155, dëshmitari W04751.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi
16 Gjykes nuk do t'ju kërkonte në asnjë moment që të kontaktoni
17 këtë preson. Kështu besoj që nuk është e nevojshme të hyni në
18 hollësi lidhur me këtë, përveç nëse --

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Thjesht desha të them që kuptojmë
20 që kjo është bërë tani rregulla 155. Në atë kohë kur jemi
21 përpjekur, kemi ndërmarrë hapa. Kaq desha të them, jo më
22 tepër.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Faleminderit.

25 Ishin këto parashtimet që kishit për sa i përket

1 përpjekjeve që keni bërë për të kontaktuar dëshmitarët?

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, përveç nëse kam
3 harruar ndonjë individ, këto ishin ato që ishin në listë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj
5 që është në rregull, i numërova. Shumë mirë atëherë. Do t'i
6 jap fjalën Prokurorisë. Dëshironi të bëni ndonjë koment lidhur
7 me këtë?

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Thjesht që të qartësojmë për
9 nevojat të procesverbalit, besoj që jam i sigurt që Avokati
10 nuk e kishte qëllim që të bënte gabim lidhur me komunikimet,
11 ajo që themi ne është që ka të bëjë me ndërkombëtarët, është
12 që nuk është e ndaluar të kontaktohen, por ne nuk kemi lirinë
13 që t'ju bashkëndajmë të dhënat e tyre personale me persona të
14 tjerë. Do të bëhet përmes autoriteteve. Do t'u kërkohen këto
15 autoriteteve për të cilat këta individë punojnë dhe që i
16 punësojnë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Nuk u lejohej që të
20 hynim në kontakt të drejtpërdrejtë, s'kishim mënyrë tjetër si
21 t'i kontaktonim.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
23 ju -- z. Avokat, nuk i keni kontaktuar autoritetet për të
24 cilat punojnë? Sepse mund ta bënit një gjë të tillë.

25 Z. AOUINI: [Përkthim] Po përpiqem të jem i sigurt se

1 cilit organ i kemi dërguar letrat tona për kontakt.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtësi i Viktimave, keni ndonjë koment për të bërë?

4 Z. LAWS: [Përkthim] Asnjë koment.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Sapo më informuan që kemi dërguar
6 një email për të dhënat e kontaktit personal, pra të W02517.
7 Kemi gjetur edhe një numër telefoni për një tjetër. Nuk jam i
8 sigurt se cili prej dy të tjerëve, por që është pa sukses. Por
9 nuk e kemi kontaktuar organin, për të cilin punon në mënyrë të
10 drejtpërdrejtë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jua
12 le juve, ky ishte një sugjerim që të siguronit informacionet e
13 tjera dhe të kontaktoni këta, pra të shohim se si shkojmë me
14 këta dëshmitarë.

15 Kisha një pyetje për Prokurorin e Specializuar. Nëse e
16 kuptoj mirë, për disa nga këta dëshmitarë, ZPS-ja mund të --
17 në qoftë se arrin në pikën kur duhet t'i thërrasim zyrtarisht,
18 me fletëthirrje, ZPS-ja do të ishte në gjendje të na japë të
19 dhënat e tyre, adresën, vendbanimin?

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po flasim për dëshmitarët e
21 tjerë, jo për tre ndërkombëtarët? Përgjigjja është po, ne do
22 jemi në gjendje që në qoftë se na kërkohet nga Trupi Gjykes
23 që të japim informacione shtesë që në atë moment duhet t'i
24 nënshtrohen redaktimeve standarde -- po natyrisht që do të
25 bashkëpunojmë lidhur me kërkesat e Trupit Gjykes, për aq sa

1 kemi mundësi.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, por tani besoj që mbaruam me këtë pikë.

4 Trupi Gjykses deshi të sqaronte tani për tani se është e
5 rëndësishme që Mbrojtja të sigurojë të dhënat, adresën,
6 vendbanimin e personave që synojnë që t'i thërrasin si
7 dëshmitar, kjo ishte e qartë, u sqarua. Dhe në qoftë se ka
8 ndonjë mundësi shtesë që Prokuroria të ndihmojë, do të na
9 ndihmojë.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Një pikë shtesë. Në qoftë se
11 arrijmë tek momenti i fletëthirrjes dhe ka ndonjë pengesë që
12 detajet e tyre të ndahen me neve, për aq kohë sa këto detaje
13 janë në dispozicion të Trupit Gjykses dhe që dëshmitari
14 paraqitet në Gjykatë, ne s'kemi nevojë detyrimisht të dimë
15 këto të dhëna personale, vendbanimin, adresën. Në qoftë se ka
16 ndonjë pengesë që neve na pengon që nuk -- për të cilat ne nuk
17 duhet të kemi qasjen në këto informacione, atëherë nuk është
18 problem për neve.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Pika e radhës ka të bëjë me kërkesat e mundshme për të
22 marrë në pyetje dëshmitarë përmes videolidhjes apo larg nga
23 salla e gjyqit.

24 Kemi konstatuar parashtrimet tuaja dhe që s'kemi gjë të
25 tjera për të thënë. Të gjitha palët dhe Avokati Mbrojtës nuk

1 kanë gjë për të shtuar në këtë pikë.

2 Faleminderit, shumë mirë. Pika 11, garancitë kundër vetë-
3 inkriminimit. Në pajtim me rregullën 151(3) të Rregullores.

4 Dhe për këtë pikë, kemi konstatuar parashtrimet tuaja në
5 qoftë se ju s'keni diçka për të shtuar në lidhje me këtë pikë,
6 mund të kalojmë tek pika e radhës. Shoh që ju s'keni asgjë për
7 të shtuar.

8 ZPS-ja dëshiron të thotë diçka. Znj. Prokurore, vazhdoni.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shkurtimisht, edhe një herë,
10 është e vështirë të bëjmë komente lidhur me këtë pikë. Pa
11 informacione shtesë për numrin e dëshmitarëve. Megjithatë,
12 është e qartë që tashmë nga shënimet që i kemi, se dëshmitari
13 4280 mund të ketë për garanci të tilla që të kemi parasysh për
14 të ardhmen.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit. Shënuam dhe këtë pikë.

17 Mbrojtësi i Viktimave, keni diçka për të shtuar?

18 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë. Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Atëherë, pika e radhës ka të bëjë me kundërshtimet e ZPS-së
21 dhe Mbrojtësin e Viktimave, lidhur me pranueshmërinë e
22 provave.

23 Mbrojtja synon që të paraqesë në gjykim, kemi konstatuar
24 parashtrimet tuaja të të dyve. Pra të Prokurorisë dhe të
25 Mbrojtësit të Viktimave.

1 Z. Prokuror, keni diçka për të shtuar atyre
2 parashtrimeve? Dhe shoh që jeni pak i habitur. Nuk thashë që
3 po kundërshtoni, thashë që është mbi çështjen që ka të bëjë me
4 pranueshmërinë e tyre.

5 Z. DE MINICIS: [Mikrofoni çaktivizuar]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duke
7 e thënë e kuptoj që mund të keqinterpretohet.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Asgjë për të shtuar për
9 parashtrimet që kemi dorëzuar me shkrim.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë nga ato që kemi dhënë me
11 shkrim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Avokat Mbrojtës, keni diçka për të thënë lidhur me këtë pikë?

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, asgjë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Pika e fundit -- jo, e parafundit. Ka ngelur edhe një gjë
18 që ka të bëjë me masat mbrojtëse për dëshmitarët e propozuar.
19 Kemi parë z. Avokat Mbrojtës që s'keni kërkuar masë mbrojtëse,
20 asnjë.

21 Diçka për të shtuar lidhur me këtë?

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Sa për nevoja të procesverbalit nuk
23 kemi kërkuar masa mbrojtëse për personat që kemi qenë në
24 gjendje të takojmë. Kjo pyetje mund të paraqitet për personat
25 që mund të ndodhë të thirren përmes fletëthirrjes nga gjykata.

1 Dhe atëherë do të bisedojmë për këtë pikë në atë kohë. Ata që
2 kemi takuar, po flasim për dy DW4-at dhe ata që kemi takuar
3 fillimisht nga ZPS-ja, nuk kemi kërkuar masa mbrojtëse.
4 Megjithatë, për të tjerët nuk mund të prononcohemi tani, duhet
5 të presim.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit. Ishte element i rëndësishëm shtesë.

8 Nga Prokuroria ka ndonjë reagim?

9 Znj. PERGOLO: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Mbrojtësi i Viktimave?

12 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull, kalojmë tek pika e fundit në agjendë që është kërkesa
15 e Mbrojtjes për të ndryshuar listën e provave. Është
16 parashtrimi i protokolluar 618, paragrafi 28-32.

17 Ka diçka që dëshironi t'u shtoni parashtrimeve me shkrim,
18 z. Avokat Mbrojtës?

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, znj. Gjykatëse. Besoj që kemi
20 shtjelluar dokumentet, arsyet për të cilat i kemi paraqitur,
21 në qoftë se këto mjaftojnë për juve, neve na mjafton dhe
22 qëndrojmë pas kësaj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
24 Prokurore apo Z. Prokuror?

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne kemi bërë vërejtjet tona

1 lidhur me relevancën e këtyre dëshmitarëve, asgjë më tepër.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtësi i Viktimave?

4 Z. LAWS: [Përkthim] S'kemi asnjë koment.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo

6 ishte pika e fundit në rendin e ditës.

7 A kanë palët apo Mbrojtësi i Viktimave ndonjë çështje,
8 pikë tjetër që dëshirojnë të diskutojnë, të paraqesin në këtë
9 kohë?

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nga ana jonë, jo, nga

11 Prokuroria.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Mbrojtësi i Viktimave?

14 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë nga ne.

15 Z. AOUBINI: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit shumë. Atëherë, besoj që palët -- ju falënderoj

18 të gjithë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave për pjesëmarrjen

19 tuaj. Falënderoj ekipin e sigurimit, stenografin dhe

20 përkthyesit për ndihmën e tyre sot.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë znj. Gjykatëse.

22 Mendoja që do të trajtojmë kundërpërgjigjen ndaj

23 përgjigjes së Mbrojtjes gojarisht, kundërpërgjigjen ndaj

24 përgjigjes së Mbrojtjes për mocionin tonë për pranimin e

25 provave.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
2 dija që Prokuroria kërkonte që të bëja këtë sepse e kanë lënë
3 hapur atë, çfarë do bëhej me gojë apo me shkrim dhe nuk kisha
4 marrë ndonjë informacion shtesë. Kërkoj ndjesë që s'kam qenë e
5 qartë. Në qoftë se dëshironi të jepni një përgjigje tani.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duhet ta kishim bërë qëllimin
7 tonë dhe menduam se do të kishte qenë më efikase që ju të na
8 kërkoni të bëjmë këtë gjë. Mund ta japim një kundërpërgjigje
9 të shkurtër që tani.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ide
11 shumë e mirë, z. Prokuror. Keni fjalën atëherë, mund të
12 vazhdoni.

13 Dhe a kemi nevojë të kalojmë në seancë private për të
14 biseduar, trajtuar, këtë pikë?

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
17 Sekretare, a mund të na kaloni në seancë private, ju lutem?

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 jemi sërish në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Nesër do të mbajmë një seancë tjetër në orën 14.30, gjatë
2 të cilës Trupi Gjykues do të lëshojë disa urdhra dhe udhëzime
3 për sa i përket paraqitjes së argumenteve të Palës Mbrojtëse.
4 Dhe pas saj do të vazhdojmë me procesin tonë.

5 Dakord, këtu përfundon seanca.

6 --- Seanca mbyllet në orën 12.38

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25